



Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000 – Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 101
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Metodologjia e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike

Përfshirë ndryshimet e bëra më 29 nëntor 2006

Përmbajtja

Përkufizimet	v
1. Hyrje	
1.1 E kaluara	1
1.2 Bazat ligjore	1
1.3 Fushëveprimi i çmimeve të rregulluara	1
1.4 Struktura e metodologjisë	2
2. Blerjet e energjisë prej Furnizuesit Publik	4
2.1 Fushëveprimi i metodologjisë	4
2.2 Parimet e Përgjithshëm	4
2.3 Tregu kalimtar	5
2.4 Përlllogaritja e vëllimit dhe çmimet e rregulluara	5
2.5 Kushtet e MBE-së	7
2.6 MNBK	8
3. Shitjet e Energjisë prej Furnizuesit Publik	9
3.1 Fushëveprimi i metodologjisë	9
3.3 Parimet e Përgjithshme	9
3.4 Kostot e blerjes së energjisë sipas MBE-ve	9
3.5 Humbjet	10
3.6 Kostot e shitjes me pakicë	11
3.7 Teprica e furnizimit	12
3.8 Tarifat përfundimtare të shitjes me pakicë	12
.1 Tarifat sociale	14
4 Të ardhurat vjetore të OPST/OT	15
4.1 Qëllimi i metodologjisë	15
4.2 Parimet e përgjithshëm	15
4.3 Qasja e ndërtimit të blloqeve	18
4.5 Përcaktimi i BAR	20
4.6 Përcaktimi i MPKK	22
4.7 Bartjet e shpenzimeve të para-2005	23

4.8	Humbjet	24
4.9	Kufiri i Përballueshmërisë	25
4.10	Të Ardhurat dhe Shpenzimet e Përrjashtuara	Error! Bookmark not defined.
4.11	Mekanizmi Simulues i Sistemit të Transmetimit (MSST)	26
4.12	Kontrolli i Çmimit	27
4.13	Të ardhurat dhe shpenzimet e OT	32
5	Pagesat për në rrjet dhe për Shfrytëzim të Sistemit të (SHTS)	33
5.1	Përmbajtja e metodologjisë	33
5.2	Parimet e përgjithshme	33
5.3.	Pagesat për Kycje (lidhje)	35
5.5	Përmbajtja e Metodologjisë	38
5.6	Parimet e Përgjithshme	38
5.7	Humbjet	38
5.9	Kontrolli i çmimit	40
6.	Pagesat për lidhje të SHSHS	41
6.1	Përmbajtja e metodologjisë	41
6.2	Parimet e përgjithshme	41
6.3	Pagesat për lidhje	42
6.4	Pagesat e SHSHS-së	43
7	Blerjet e Energjisë elektrike me çertifikata të origjinës	44
	Ekuacioni 2-1 MNBK	8
	Ekuacioni 3-1 Kostoja e Lejuar me Pakicë	13
	Ekuacioni 3-2 Të ardhurat totale nga tarifat e pakicës	13
	Ekuacioni 4-1 Shuma e lejuar e humbjeve të Transmisionit	24
	Ekuacioni 4-2 Faktori Rregullues i Humbjeve të Transmisionit	25
	Ekuacioni 4-3 Kostot e Balancimit të OST	27
	Ekuacioni 4-4 MSST	27
	Ekuacioni 4-5 Të ardhurat e lejuara të OST	30
	Ekuacioni 4-6 Faktori Korrigjues i OST	31
	Ekuacioni 4-7 Të Ardhurate e Lejuara ITC	31
	Ekuacioni 5-1 Të ardhurat e lejuara të OSSH-së	40
	Ekuacioni 5-2 Faktori i korrigjues i OSSH	40



Ekuacioni 5-3	Të ardhurat e lejuara të OSSH	38
Ekuacioni 5-4	Faktori korrigjues i OSSH	38

Përkufizimet

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	Ndërmarrja/et e energjisë elektrike të licencuara për të marrë përsipër këtë aktivitet prej ZRRE-së
Mekanizmi kompensues Ndër-OST	Mekanizmi kompensues midis OST-ve për bartjen e rrjedhave tranzitore të energjisë, që është miratuar ndërmjet anëtarëve të Komunitetit të Energjisë për Evropën juglindore.
Operatori i Tregut	Ndërmarrja/et e energjisë elektrike të licencuara për të marrë përsipër këtë aktivitet prej ZRRE-së
Rregullat e Tregut	Rregullat që qeverisin tregtinë midis Operatorit të Tregut dhe pjesëmarrësve në treg, si dhe ndërveprimi midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, për qëllimin e mirëmbajtjes së ekuilibrit fizik të tregut
Rregulli mbi Çmim-vënien	Rregulli mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike
Prodhues Publik	Një prodhues me një central energjetik me kapacitet të instaluar mbi 5 MW, i cili është ekzistues dhe është funksional në datën e shpalljes së Ligjit mbi Energjinë Elektrike (30 qershor 2004)
Furnizuesi Publik	Ndërmarrja/et e energjisë elektrike të licencuara për të marrë përsipër këtë aktivitet prej ZRRE-së
Kodi i Tregtisë	Rregullat e Tregut
Operatori i Sistemit të Transmetimit	Ndërmarrja/et e energjisë elektrike të licencuara për të marrë përsipër këtë aktivitet prej ZRRE-së
Modeli Simulues i Tregut me Shumicë	Modeli i Simulimit të Tregut i përshkruar në Shtojcën 1 të Rregullave të Tregut

Terma të tjerë të përdorur në këtë metodologji, do të kenë të njëjtin kuptim si ato të dhënë në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ose në Rregullat e Tregut.

Shkurtesat dhe Akronimet

MSBK	Mekanizmi Stimulues për Balancimin e Kostove
CDK	Çertifikatat e Disponueshmërisë së Kapacitetit
MÇAK	Modeli i Çmim-vënies së Asetit Kapital
IÇK	Indeksi i Çmimit të Konsumit
FHSH	Faktori i Humbjes gjatë Shpërndarjes
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
SHSSH	Shfrytëzimi i Sistemit të Shpërndarjes
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
KPFE	Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

IÇKH	IÇK-ja e Harmonizuar (Bashkimi Evropian)
KPMM	Komisioni i Pavarur mbi Minierat dhe Mineralet
MKNO	Mekanizmi Kompensues ndër -OST
OPST/OT	Operatori i Pavarur i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut (Themeluar prej 1 korrikut 2006 si KOSTT)
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut i Kosovës
KAM	Kostot Afatgjata Marxhinale
OT	Operatori i Tregut
MBE	Marrëveshja për Blerjen e Energjisë
VA	Vlera Aktuale
BAR	Baza e Asetit të Rregulluar
ZSK	Zyra Statistike e Kosovës
FHT	Faktori i Humbjes gjatë Transmisionit
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit
MSST	Mekanizmi Stimulues i Sistemit të Transmisionit
SHST	Shfrytëzimi i Sistemit të Transmisionit
MPKK	Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit
MSTSH	Modeli Simulues i Tregut të Shumicës

Parametrat e Ekuacioneve

ACPI	Kostot Totale Reale që ka Furnizuesi Publik nga blerjet e energjisë prej importeve	Ekuacioni 3-5
ACPPK	Kostot Totale Reale që ka Furnizuesi Publik nga blerjet e energjisë prej gjeneratorëve në Kosovë	Ekuacioni 3-5
ACUS	Numri real i konsumatorëve në mes të vitit	Ekuacioni 3-5
ADIS	Energjia reale që hyn në rrjetin e shpërndarjes (GWh)	Ekuacioni 6-2
AELIG	Të ardhurat vjetore totale që ka Furnizuesi Publik nga shitjet e	Ekuacioni 3-5

	energjisë tek konsumatorët e privilegjuar që janë në Kosovë, pagesat neto të SHST dhe SHSSH të paguara nga Furnizuesi Publik në emër të këtyre konsumatorëve dhe ndonjë pagesë tjetër shtesë ose teprica të taksuara për të mbuluar kostot e shërbimit të vetë Furnizuesit Publik	
AEXPT	Të ardhurat vjetore totale që ka Furnizuesi Publik nga eksportet e energjisë	Ekuacioni 3-5
AGEN	Prodhimi real i nxjerrë dhe i importuar, që hyn në sistemin e transmetimit (GWh)	Ekuacioni 4-2
ALOS	Pagesat totale reale të marra nga Furnizuesi Publik prej OST dhe OSSH për blerjen e energjisë për të mbuluar humbjet në rrjet	Ekuacioni 3-5
ASUBI	Subvencioni real i marrë për blerjet e importit	Ekuacioni 3-5
ASUBL	Çdo subvencion tjetër real i marrë për të mbuluar pjesërisht ose të gjithë të ardhurat vjetore të pa-arkëtuara	Ekuacioni 3-5
ASUBV	Subvencioni real i marrë për mbrojtjen e konsumatorëve të varfër	Ekuacioni 3-5
AVOL	Energjia reale e furnizuar tek konsumatorët e lidhur me rrjetin e shpërndarjes	Ekuacioni 6-3 Ekuacioni 6-4
AWEP	Çmimi real mesatar i energjisë elektrike në tregun e shumicës (€/MWh) – mesatarja përgjatë viti, e Ponderuar përmes prodhimit real të nxjerrë dhe importuar, që hyn gjatë çdo ore në rrjetin e transmetimit	Ekuacioni 4-2 Ekuacioni 6-2
BALC	Kostot neto totale balancuese të Furnizuesit Publik	Ekuacioni 2-1
BASF	Kostot neto totale balancuese të Furnizuesit Publik (%)	Ekuacioni 4-4
BCOS	Kosto balancuese të OST-së të mbuluara prej shfrytëzuesve të sistemit	Ekuacioni 4-3
BLLM	Kufiri më i ulët i pagesës së kostove stimuluese balancuese për OST-në (përcaktuar nga ZRRE)	Ekuacioni 4-4
BSCC	Kostot neto të OST-së për kontratat e disponueshmërisë ose shfrytëzimit të shërbimeve	Ekuacioni 4-3 Ekuacioni 4-4

	balancuese, përveç kostove të përfshira brenda CSOB	
BULM	Kufiri më i lartë i pagesës së kostove stimuluese balancuese për OST-në (përcaktuar nga ZRRE)	Ekuacioni 4-4
CONG	Të ardhurat vjetore neto të lëshuara prej fondit të menaxhimit të kongjestionit	Ekuacioni 4-5
CPI	Indeksi i çmimit të konsumit për i harmonizuar për Bashkimin Evropian. Rritja vjetore e përqindjes së publikuar për vitin t-1 do të përdoret për të përcaktuar vlerën që do të aplikohet në vitin t.	Ekuacioni 6-3
CPPI	Kostot totale të parashikuara që ka Furnizuesi Publik për blerjet e energjisë nga importet	Ekuacioni 3-3
CPPK	Kostot totale të parashikuara që ka Furnizuesi Publik për blerjet e energjisë nga prodhuesit në Kosovë	Ekuacioni 3-3
CSOB	Kostot neto të OST-së për ofertat dhe propozimet e pranuar në mekanizmin balancues	Ekuacioni 4-3 Ekuacioni 4-4
CUSS	Numri i konsumatorëve jo të privilegjuar dhe të privilegjuar të cilët shërbehen nga Furnizuesi Publik	Ekuacioni 3-1
DALO	Niveli i lejuar i humbjes (%) – mesatarja e Ponderuar vjetore e matur me energjinë e parashikuar për të hyrë çdo ore në rrjetin e shpërndarjes	Ekuacioni 6-1 Ekuacioni 6-2
DEPS	Amortizimi i lejuar për Furnizuesin Publik, që përcaktohet nga ZRRE-ja, në lidhje me asetet që shfrytëzohen për të siguruar shërbime me shumicë dhe pakicë	Ekuacioni 3-1
DISK	Faktori korrigjues për diferencat në të ardhurat vjetore të lejuara në vitin paraprak, të cilat janë pasojë e ndryshimeve midis vëllimeve reale dhe të parashikuara të furnizimit	Ekuacioni 6-3 Ekuacioni 6-4
DLAD	Rregullimi i diferencave midis humbjeve të lejuara të vitin paraprak, bazuar në energjinë e parashikuar të shpërndarë, dhe çmimet e tregut, si dhe energjinë reale të shpërndarë, si edhe diferencat midis humbjeve reale	Ekuacioni 6-1 Ekuacioni 6-2

	të lejuara dhe atyre të parashikuara të transmetimit dhe komerciale	
DLOS	Humbjet e lejuara teknike gjatë shpërndarjes, përfshirë në kontrollin e çmimit (€)	Ekuacioni 6-1 Ekuacioni 6-2 Ekuacioni 6-3
DMAR	Të ardhurat vjetore maksimale të lejuara për OSSH, përpara rregullimeve	Ekuacioni 6-3
DREV	Të ardhurat vjetore të OSSH prej tarifave të SHSHS	Ekuacioni 3-3 Ekuacioni 3-4 Ekuacioni 6-3
ELIG	Të ardhurat vjetore totale të parashikuara që ka Furnizuesi Publik nga shitjet e energjisë tek konsumatorët e privilegjuar që janë në Kosovë, pagesat neto të SHST dhe SHSSH të paguara nga Furnizuesi Publik në emër të këtyre konsumatorëve dhe ndonjë pagesë tjetër shtesë ose teprica të taksuara për të mbuluar kostot e shërbimit të vetë Furnizuesit Publik	Ekuacioni 3-3
EXPT	Të ardhurat vjetore totale të parashikuara që ka Furnizuesi Publik nga eksportet e energjisë	Ekuacioni 3-3
FDIS	Energjia e parashikuar që hyn në rrjetin e shpërndarjes (GWh)	Ekuacioni 6-1 Ekuacioni 6-2
FGEN	Prodhimi i parashikuar që nxirret dhe importet që hyjnë në rrjetin e transmetimit (GWh)	Ekuacioni 4-1 Ekuacioni 4-2
FLOS	Pagesat totale të parashikuara që janë marrë nga Furnizuesi Publik prej OST-së dhe OSSH-së për blerjen e energjisë për të mbuluar humbjet e rrjetit (përllogaritur si shuma e TLOS+DLOS)	Ekuacioni 3-3
FORT	Vëllimet e parashikuar që dalin nga sistemi i transmetimit për qëllime rregullimi	Ekuacioni 4-6
FVOL	Energjia e parashikuar e furnizuar tek konsumatorët që janë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes	Ekuacioni 6-2 Ekuacioni 6-4
FWEP	Çmimi mesatar i parashikuar i tregut të energjisë elektrike me shumicë (€/MWh) – mesatarja e Ponderuar vjetore e matur përmes prodhimit të parashikuar që është nxjerrë si dhe importeve që kanë hyrë çdo orë në rrjetin e transmetimit	Ekuacioni 4-1 Ekuacioni 6-1

ILOS	Niveli i parashikuar i humbjeve (%) që rezultojnë nga rrjedhjet e tranzitit – mesatarja përgjatë vitit	Ekuacioni 4-1
INTR	Norma e aplikueshme e interesit (% , përcaktuar nga ZRRE-ja) – kjo kompenson firmën/konsumatorët për interesa të tjerë të të ardhurave që rezultojnë prej vonesave të aplikimit të korigjimit	Ekuacioni 4-2 Ekuacioni 4-4 Ekuacioni 4-6 Ekuacioni 4-7 Ekuacioni 6-2 Ekuacioni 6-4
ITCA	Të ardhurat vjetore neto reale të MNKO, përcaktuar në baza ITC ex-post	Ekuacioni 4-7
ITCM	Të ardhurat vjetore neto të MKNO	Ekuacioni 4-5 Ekuacioni 4-7
KPS	Faktori korigjues për diferencën midis kostove të parashikuara dhe atyre reale të Furnizuesit Publik, kostove të parashikuara dhe atyre reale të blerjes së energjisë dhe subvencionet e parashikuara dhe reale që janë marrë	
MARG	Teprica e lejuar e furnizimit (%)	Ekuacioni 3-1
MREV	Të ardhurat vjetore të lejuara të OT prej tarifave të SHTS	Ekuacioni 3-2
NCUS	Numri i konsumatorëve jo-të privilegjuar në mes të vitit	Ekuacioni 3-2 Ekuacioni 3-5
NDREV	Kostot totale të paguara OST-së dhe OSSH-së përmes pagesave të SHST për sigurimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me furnizimin e konsumatorëve jo të privilegjuar	Ekuacioni 0-5
NMREV	Kostot totale të mbuluara nga OT përmes pagesa të SHST për sigurimin e shërbimeve të lidhura me furnizimin e konsumatorëve jo të privilegjuar	Ekuacioni 0-5
NTREV	Kostot totale të paguara prej OSSH-së përmes pagesave të SHST për sigurimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me furnizimin e konsumatorëve jo të privilegjuar	Ekuacioni 0-5
OPXS	Kostot totale të operimit dhe mirëmbajtjes të lejuara për furnizuesin Publik, për sigurimin e shërbimeve me pakicë dhe shumicë	Error! Reference source not found.
PASS	Kostot neto balancuese të përcjella tek konsumatorët e Furnizuesit Publik	Ekuacioni 2-1 Ekuacioni 3-2

PCAP	-Ponderimi tavan në kontrollin e çmimit (%), përqindja e kostove që mendohet se do të varen nga ndryshimet në vëllime)	Ekuacioni 6-3
PPUR	Kostot e lejuara të blerjes së energjisë për furnizimin e konsumatorëve jo të privilegjuar.	Ekuacioni 3-1
RETL	Kostoja e lejuar me pakicë (€konsumator)	Ekuacioni 3-1
RTAR	Kostot Totale të mbuluara prej tarifave me pakicë	Ekuacioni 3-2
SINC	Rregullimi stimulues i OST	Ekuacioni 4-3 Ekuacioni 4-4
SUPL	Të ardhurat vjetore të lejuara të Furnizuesit Publik	Ekuacioni 2-1 Ekuacioni 3-1 Ekuacioni 3-2
SUBI	Çdo subvencion i siguruar për blerje të importeve	Ekuacioni 0-4
		Ekuacioni 0-6
SUBL	Çdo subvencion tjetër i siguruar, përfshirë mbulimin e pjesshëm ose të plotë të të ardhurave vjetore të pa-arkëtuara	Ekuacioni 0-5 Ekuacioni 0-6
SUBV	Çdo subvencion i siguruar për mbrojtjen e konsumatorëve të varfër	Ekuacioni 3-2 Ekuacioni 0-6
TABC	Caku për $BCOS_{t-1}$ përveç $SINC_{t-1}$ (përcaktuar nga ZRRE-ja)	Ekuacioni 4-4
TALO	Niveli i lejuar i humbjes gjatë transmetimit (%) – mesatarja e Ponderuar vjetore prej prodhimit të parashikuar të nxjerrë dhe importet që hyjnë çdo orë në rrjetin e transmetimit	Ekuacioni 4-1 Ekuacioni 4-2
TLAD	Rregullimi i diferencave midis humbjeve të lejuara në vitin paraardhës, bazuar në prodhimin e parashikuar, importet dhe çmimet e tregut, prodhimin aktual	Ekuacioni 4-1 Ekuacioni 4-2
TLOS	Humbjet e lejuara gjatë transmetimit të përfshira në kontrollin e çmimeve (€)	Ekuacioni 4-1 Ekuacioni 4-2
TMAR	Maksimumi i të ardhurave vjetore të lejuara për OST-në, përpara rregullimeve	Ekuacioni 4-5 Ekuacioni 4-5
TRAK	Faktori korrigjues për diferencat në të ardhurat vjetore të lejuara të	Ekuacioni 4-5

	OST-së gjatë vitit paraprak që rezulton prej ndryshimeve midis vëllimeve të parashikuar dhe atyre realisht të transmetuar	Ekuacioni 4-6
TRAN	Vëllimet aktuale të sistemit ekzistues transmetues për qëllimet e ndreqjes	Ekuacioni 4-6
TREV	Të ardhurat vjetore të lejuara të OST-së prej tarifave të SHTS	Ekuacioni 3-2 Ekuacioni 4-5 Ekuacioni 4-6
TSIT	Vëllimi i parashikuar i rrjedhjeve tranzit në vit (GWh)	Ekuacioni 4-1
X	Faktori X, që përfaqëson ndryshimin e vërtetë vjetor në të ardhurat vjetore të lejuara (përcaktuar nga ZRRE-ja me vlera ndryshuese për çdo firmë)	Ekuacioni 4-5 Ekuacioni 6-3

1. Hyrje

Sipas autoritetit të dhënë në Nenin 46 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në një seancë publike të mbajtur më 15 dhjetor 2005, ka miratuar Metodologjinë e Tarifave. Metodologjia e Tarifave më pas është ndryshuar për të përfshirë ndryshimet që janë nevojitur për shkak të funksionimit të një modeli të tregut të përkohshëm dhe çështjeve që dolën gjatë rrjedhës së shqyrtimit të parë të çmimit që është ndërmarrë nga ZRRE-ja gjatë vitit 2006. ZRRE-ja do të vazhdojë të mbajë nën shqyrtim Metodologjinë e Tarifave dhe do ta miratojë siç nevojitet. Të gjitha këto rifreskime do të botohen përpara se të hyjnë në fuqi.

Periodha në të cilën mendohet të futet në veprim modeli i tregut të përkohshëm dhe dispozitat përkatëse të kësaj Metodologjie të Tarifave që do të aplikohen, do të njoftohen herë pas here prej ZRRE-së, ose siç përcaktohet në Rregullat e Tregut që janë në fuqi gjatë çdo periudhe.

1.1 E kaluara

Ligji për Rregullatorin e Energjisë kërkon që:

Rregullimi i çmimeve do të qeveriset prej një metodologjie tarifash, e cila do të zhvillohet dhe nxirret nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji. (Neni 46.1)

Metodologjia mbulon përcaktimin e të ardhurave totale të lejuara që mund të fitohen prej tarifave të rregulluara, dhe parimeve që qeverisin strukturën e tarifave të përdorura për mbulimin e këtyre të ardhurave vjetore.

Do të jetë përgjegjësia e të licencuarve që nëse është e nevojshme, të propozojë për shqyrtim dhe aprovim nga ZRRE-ja, tarifa të rregulluara që janë në përputhje me të ardhurat e lejuara të përcaktuara nga ZRRE-ja. Procesi i shqyrtimit dhe aprovimit të tarifave të rregulluara, përcaktohet në Rregullin mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike. (“Rregulli mbi Çmim-vënien”).

1.2 Bazat ligjore

Ligji për Rregullatorin e Energjisë nuk specifikon qëndrimin ligjor të metodologjisë së tarifave, përveç atij të nxjerrë prej Bordit të ZRRE-së. Ne kemi propozuar që metodologjia të lëshohet në formën e një vendimi të Bordit të ZRRE-së. Metodologjia nuk do të ketë statusin e një rregulli, gjë që e bën më të lehtë zbatimin e ndryshimeve të ardhshme. Të licencuarve do t’u kërkohej të jenë në pajtim me kushtet e metodologjisë, sipas kushteve të licencës së tyre dhe Rregullit mbi Çmim-vënien, i cili përcakton parimet e përgjithshme me të cilat duhet të përputhen këto tarifa.

1.3 Fushëveprimi i çmimeve të rregulluara

Figura 1 ilustron një përmbledhje të çmimeve që janë të rregulluar dhe atyre që nuk janë të rregulluar. Kjo metodologji siguron më shumë detaje mbi çmimet individuale që i nënshtrohen rregullimit dhe formës që merr ky rregullim.

Figura 1 Tarifat e Rregulluara

	Furnizuesi Publik	Furnizuesit e tjerë	TSO	DSO	Konsumatorët jo të Privilegjuar	Konsumatorët e Privilegjuar
Prodhuesi Publik	PPA	MBE	TUOS Pagesa per lidhje	er		
IPPs			TUOS Pagesa per lidhje	DUOS Pagesa per lidhje		
Furnizuesi Publik			TUOS	DUOS	Çmimi me pakice	
Furnizuesit e Tjerë			TUOS	DUOS		
Konsumatorët jo të privilegjuar			Pagesa per lidhje	Pagesa per lidhje		
Konsumatorët e Privilegjuar			Pagesa per lidhje	Pagesa per lidhje		

1.4 Struktura e metodologjisë

Metodologjia ndahet në tetë seksione të mëtejshme, siç vijon:

- Seksioni 2 – përcaktimi i kostove të blerjeve të energjisë elektrike prej Furnizuesit Publik, për qëllimet e shërbimit të konsumatorëve jo të privilegjuar.
- Seksioni 3 – përcaktimi i kostove të shërbimit të Furnizuesit Publik dhe struktura e tarifave përfundimtare të ngarkuara prej Furnizuesit Publik, tek konsumatorët jo të privilegjuar.
- Seksioni 4 – përcaktimi i të ardhurave të lejuara që do të mbulohen nga Operatori i Pavarur i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Tregut (OPSTOT), duke bërë dallimin midis funksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatorit të Tregut (OT).
- Seksioni 5– Struktura e shfrytëzimit transmetues të sistemit (SHTS) dhe tarifat e lidhjes.
- Seksioni 6 – përcaktimi i të ardhurave të lejuara që do të mbulohen prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- Seksioni 7– struktura e shfrytëzimit përdorues të sistemit (SHPS) dhe tarifat e kyçjes.
- Seksioni 8 – përcaktimi i kostove të blerjes së energjisë prej prodhuesve me certifikata origjine.

Çdo seksion fillon me një përshkrim të detajuar të fushëveprimit të metodologjisë në lidhje me përmbajtjen e seksionit. Kjo pasohet prej një përshkrimi të parimeve të përgjithshëm të aplikuar sipas metodologjisë për rregullimin e këtyre kostove dhe çmimeve, duke përfshirë një përmbledhje



të elementëve kryesorë të qasjes së përdorur. Më pas vijon një përshkrim i detajuar i këtyre elementëve.

2. Blerjet e energjisë prej Furnizuesit Publik

2.1 Fushëveprimi i metodologjisë

Ligji për Energjinë Elektrike kërkon nga të gjithë prodhuesit me centrale energjetike, me një kapacitet të instaluar që tejkalojnë 5MW, që prej 30 qershorit 2004 (data e shpalljes së Ligjit për Energjinë Elektrike), të ofrojnë energjinë elektrike të prodhuar prej këtyre centraleve tek furnizuesi publik me një çmim të rregulluar, në rast se furnizuesi publik kërkon energji elektrike. Për qëllimet e kësaj metodologjie, këto janë parafrazuar si “Prodhues Publikë”.

ZRRE ka përcaktuar se ky kriter do të aplikohet vetëm për shitjet prej prodhuesve Publikë tek furnizuesi publik, në mënyrë që të plotësohen kërkesat e konsumatorëve jo të privilegjuar. Edhe pse konsumatorët e privilegjuar mund të zgjedhin të shërbehen prej furnizuesit publik, blerjet prej furnizuesit publik për këtë qëllim, do të jenë me çmim të parregulluar pasi ZRRE-ja të ketë konfirmuar që këto blerje janë me kosto më të ulëta (shih seksionin 3.3). Blerjet prej furnizuesve që nuk janë publikë, do të bëhen gjithashtu me çmime të parregulluara. Nëse kërkohet të plotësohen kërkesat e konsumatorëve jo të privilegjuar, shitjet prej prodhuesve jo-Publikë tek furnizuesi publik, do të jenë gjithashtu të parregulluara. Do të vazhdojë të ketë kontroll rregullator për sa i përket arsyeshmërisë së këtyre çmimeve, duke përdorur autoritetin e ZRRE-së si rregullator konkurrues për industrinë e energjisë elektrike.

Vëllimi dhe çmimet e rregulluar për shitjet prej prodhuesve Publikë tek furnizuesi publik, për plotësimin e nevojave të konsumatorëve jo të privilegjuar, do të përfshihet në marrëveshjet për blerjen e energjisë (MBE-të) midis prodhuesve publikë dhe furnizuesit publik. Vlerat do të rishikohen çdo vit, në përputhje me këtë metodologji, ndërsa MBE-ja si e plotë, do të rinegociohet çdo pesë vjet, në përputhje me kriteret e Nenit 21 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Furnizuesi publik do të mbetet përgjegjës për, ose do të pranojë të hyra prej çdo tarife, të përcaktuar në përputhje me Rregullat e Tregut, që rezultojnë prej pabarazive midis kërkesës aktuale të konsumatorëve jo të privilegjuar në një periudhë ujdje, dhe furnizimit të kontraktuar prej prodhuesve publikë (si dhe burimeve të tjera). Një pjesë e ndonjë kostoje ose të ardhure rezultuese, do t’u kthehet konsumatorëve jo të privilegjuar të furnizuesit publik, përmes një “mekanizmi stimulues për balancimin e tarifave” (MSBT).

Çmimi i certifikatave të disponueshmërisë së kapacitetit (ÇDK) që duhet të blihet prej furnizuesve në përputhje me Rregullat e Tregut, nuk është rregulluar sipas kësaj metodologjie. Çmimet e ÇDK do të përcaktohen prej dënimit të aplikuar për mungesat në numrin e ÇDK-ve që janë të lidhura me detyrimet që i vendosen secilit furnizues. Ky çmim ndëshkues do të jetë një çmim i rregulluar në vetvete, dhe përmbajtja gjendet në një shtojcë të Rregullave të Tregut, dhe për këtë arsye nuk ka nevojë të përfshihen rregullime shtesë përmes kësaj metodologjie.

2.2 Parimet e Përgjithshëm

Synimi është që në përputhje me Rregullat e Tregut, të ekzistojë një çmim i tregut të shumicës i publikuar, i cili do të pasqyrojë kostot e pritshme të blerjes me çmime të parregulluar nga një treg konkurrues shumice. Kjo do të përdoret për të përcaktuar tregtitë dhe blerjet e balancuara të

tregut nga ana e furnizuesit publik, që tejkalojnë ato që mbulohen prej MBE-ve me prodhuesit publikë, duke shmangur diskriminimin midis konsumatorëve të privilegjuar dhe atyre jo të privilegjuar, si dhe duke pakësuar rrezikun që çmimet e parregulluara do të çojnë në shtrembërime diku tjetër në tregun e energjisë elektrike. Çmimi i simuluar i tregut të shumicës, do të përcaktohet në përputhje me modelin e simuluar të tregut të shumicës (MSTSH) që përshkruhet në Rregullat e Tregut.

Për këtë arsye, metodologjia kërkon që furnizuesi publik të përgatisë parashikime të kërkesës prej konsumatorëve jo të privilegjuar, të cilat do të plotësohen çdo [orë], gjatë vitit pasardhës. Çmimi i rregulluar me të cilin prodhuesit publikë shesin tek furnizuesi publik, përcaktohet çdo vit, duke përdorur një simulim të çmimeve të pritura në një treg shumice konkurrues të energjisë elektrike në Kosovë. Ky simulim formon pjesë të Rregullave të Tregut.

Në mënyrë që të sigurohet një stimulim për furnizuesin publik i cili do të bëjë parashikime të kujdesshme, do t'i kërkohej që të mbajë një pjesë të kostove prej çdo difference midis kërkesës parashikuese të inkorporuar në MBE-të midis furnizuesit publik dhe prodhuesve publikë, si dhe kërkesës reale prej konsumatorëve jo të privilegjuar në çdo periudhë ujdje.

MBE-ja midis furnizuesit publik dhe prodhuesve publikë do të shkruhet në formë të kontratave për diferenca (KPD) kundrejt çmimit të rregulluar të simuluar. MBE-të do të lejojnë që prodhuesit publikë të mbulojnë të ardhurat e tyre vjetore të lejuara siç është përcaktuar nga ZRRE-ja në përputhje me Seksionin 8 të kësaj Metodologjie të Tarifave.

2.3 Tregu kalimtar

Gjatë fazës së tregut kalimtar deri në zbatimin e rregullave të plota të tregut, nuk do të ketë çmim të simuluar të tregut. Në vend të kësaj, shitjet nga prodhuesit publikë tek furnizuesi publik do të bëhen përmes një MBE-je të thjeshtë të hartuar për të lejuar që prodhuesit publikë të mbulojnë të ardhurat e tyre vjetore të lejuara, të përcaktuar nga ZRRE-ja, në qoftë se prodhimi real është i barabartë me prodhimin e parashikuar. Kjo jep një stimul për ata prodhues në mënyrë që ata të rrisin prodhimin përtej niveleve të parashikuar, të cilët do të lejojnë zhvendosjen e importeve më të kushtueshëm.

2.4 Përlllogaritja e vëllimit dhe çmimet e rregulluara

Furnizuesit publik i kërkohej të përgatisë një parashikim vjetor mbi kërkesën e konsumatorëve jo të privilegjuar gjatë çdo ore. Ky parashikim aprovohet nga ZRRE-ja dhe më pas përfshihet në supozimet për modelin simulues të tregut të shumicës (MSTSH), të përdorur nga [Operatori i Tregut], për të përgatitur një parashikim vjetor për çmimet momentale në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me Rregullat e Tregut. MSTSH-ja zhvillon një kurbë kohëzgjatjeje të çmimit për vitin e ardhshëm, e cila lejon prodhuesin marxhinal të plotësojë kërkesat e sistemit për të mbuluar kostot e veta fikse, me anë të një rritjeje çmimi përmbi kostot e ndryshueshme gjatë orëve të pikut, ku çmimet e tregut nuk mund të tejkalojnë çmimin më të ulët të importit, ose vlerën e ngarkesës së humbur gjatë ndonjë ore.

Çmimi i përlllogaritur i shumicës për çdo orë i cili rrjedh prej MSTSH-së, përdoret si çmimi i rregulluar që aplikohet tek shitjet e prodhuesve publikë tek furnizuesit publikë. Megjithatë, siç

përshkruhet më sipër, çmimi përfundimtar efektiv do të varet prej të ardhurave vjetore të lejuara të cilat përfshihen në MBE-në midis furnizuesit publik dhe prodhuesve publikë.

Përgjegjësitë për përgatitjen dhe aprovimin e parametrave të tjerë të përdorur në MSTSH, si dhe vetë modeli, janë detajuar në Rregullat e Tregut. Këto tregohen në formën përmbledhëse në Tabelën 1 .

Tabela 1: Parametrat e Modelit Simulues të Tregut të Shumicës

Parametri	Bazat e Supozimit	Supozim i propozuar prej	Supozimet aprovuara prej	e
<i>Kërkesa</i>				
Konsumatorët privilegjuar	jo të Kërkesa historike Parashikimi i rritjes së Kërkesës Ndryshimet në të drejtën për të zgjedhur	Furnizuesi publik	ZRRE	
Konsumatorët privilegjuar	e Kërkesa historike Furnizimet kontraktuara Parashikimi i rritjes së Kërkesës Ndryshimet në të drejtën për të zgjedhur Ndërrimi i konsumatorëve	Furnizuesit (përfshirë furnizuesin publik) dorëzojnë parashikimet individuale tek OPSTOT OPSTOT përgatit parashikimin përfundimtar.	[ZRRE]	
Eksportet	Eksportet e kontraktuar Zhvillimet në Tregun Rajonal	Furnizuesit (përfshirë furnizuesin publik) dorëzojnë parashikimet individuale tek OPSTOT OPSTOT përgatit parashikimin përfundimtar.	[ZRRE]	
<i>Kapaciteti Disponueshëm</i>				
Kapaciteti operacional	Kapaciteti i instaluar i njësive operacionale	Prodhuesit	OPSTOT(ka të drejta testuese)	
Oraret e mirëmbajtjes	Kriteret historike të mirëmbajtjes	Prodhuesit	OPSTOT	
Norma të detyruara të ndërprerjeve	Normat historike të ndërprerjeve detyruara	Prodhuesit	OPSTOT	
<i>Kostot Variabile</i>				
Kostot e karburantit				
- linjit	Kostot historike, të rregulluar	Prodhuesit për	[Komisioni i Pavarur për Minierat dhe	

Parametri	Bazat e Supozimit	Supozim i propozuar prej	Supozimet aprovuara prej	e
	përmirësimet e pritura të efikasitetit		Mineralet]	
- të tjerë	Kontratat e furnizimit me karburant Lëvizjet e parashikuara të çmimeve ndërkombëtare	Prodhuesit	[ZRRE]	
Kostot operative dhe mirëmbajtjes	<i>Variable</i> të Kostot historike të rregulluara për përmirësimet e pritura efikase	Prodhuesit	[ZRRE]	
<i>Kostot Fikse</i>				
Baza e asetit	kostot aktuale të zhvlerësuara të asetëve	Prodhuesit	ZRRE	
Kthimi i lejuar	Mesatarja e r e kostos së kapitalit e vlerësuar [komerciale]	ZRRE	ZRRE	
Kostot fikse operative dhe të mirëmbajtjes	Kostot historike të rregulluara për përmirësimet e pritura efikase	Prodhuesit	[ZRRE]	
<i>Importet</i>				
Të përfshira në rendin merititor	Importet e kontraktuar Kostot historike të importit Zhvillimet e tregut rajonal	OPSTOT	ZRRE	

2.5 Kushtet e MBE-së

Vëllimi i parashikuar i kërkesës prej konsumatorëve jo të privilegjuar dhe çmimi i rregulluar, do të përfshihen në MBE-të midis prodhuesve publikë dhe furnizuesit publik. Çmimi i përfshirë në MBE do të jetë një mesatare e me vëllim të vetmuar të çmimeve gjatë çdo ore, të cilat rrjedhin nga WMSM. Meqë çmimi i rregulluar nuk varet nga njësitë që janë duke prodhuar realisht në çdo orë, nuk është e nevojshme të përcaktohet se cilat njësi individuale po furnizojnë konsumatorët jo të privilegjuar. Për këtë arsye, do të nevojiten MBE të ndara për çdo pronar të prodhuesve publikë, por jo për çdo njësi prodhuese publike të veçantë. Nëse një prodhues publik është i paaftë për të prodhuar në përputhje me porositjen e simuluar, atëherë çdo kosto shtesë prej shfrytëzimit të njërive më të shtrenjta, ose blerjeve të furnizimeve prej burimeve të tjera, do të bien mbi prodhuesin publik në fjalë, dhe jo mbi furnizuesin publik.

2.6 MNBK

MNBK është një mekanizëm stimulues me shkallëzim dinamik, i cili siguron nxitje për furnizuesin publik për të minimizuar përgjegjësinë e tij për tarifën e pa balancuar, kryesisht përmes parashikimit të kujdesshëm të kërkesës, por edhe përmes kërimit të mundësive për rritjen e menaxhimit të anës së kërkesës midis konsumatorëve të vet. Sipas MNBK-së, jo gjithë tarifën e pa balancuar përçohen tek konsumatorët jo të privilegjuar, ku furnizuesit publik i kërkohet të mbajë ndonjë pjesë të kostove dhe të ardhurave .

Vetëm një përqindje e vogël e të ardhurave të furnizuesit publik mund të ekspozohen sipas MNBK-së, ndërsa furnizuesi publik fiton vetëm një tepriçë të vogël fitimi. Duke i kërkuar furnizuesit publik të mbajë tarifën balancuese që kalojnë këtë tepriçë fitimi, kjo do ta shpinte atë me shpejtësi drejt falimentimit. Për këtë arsye, duhet të vendoset një kufi mbi kostot maksimale që duhet të paguhet prej furnizuesit publik. Në interesat e ekuiteteve, kjo duhet të krahasohet me një kufi mbi të ardhurat maksimale që një furnizues publik mund të fitojë prej tarifave të pabalancuara.¹

MNBK-ja përshkruhet me formulën vijuese:

Ekuationi 2-1 MNBK

$$\begin{aligned} \text{Nëse } BALC_t > 0, \text{ Atëherë } PASS_t &= \min [0.01 * SUPL_t ; 0.30 * BALC_t] - BALC_t \\ \text{If } BALC_t < 0, \text{ atëherë } PASS_t &= BALC_t - \max [-0.01 * SUPL_t ; 0.30 * BALC_t] \end{aligned}$$

$BALC_t$ *Kostot Balancuese Neto Totale të Furnizuesit Publik*

$PASS_t$ *Kostot Balancuese të përçuara tek konsumatorët e Furnizuesit Publik*

$SUPL_t$ *Të ardhurat të lejuara të Furnizuesit Publik (Shih seksionin 0)*

Afati i MNBP për periudhën kalimtare të tregut, është vendosur zero.

¹ Kjo ndodh kur balancimi i furnizuesit publik kontribuon në zvogëlimin e sistemit të përgjithshëm balancues. P.sh, nëse furnizuesi publik është i gjatë dhe sistemi është i shkurtër, atëherë furnizuesi publik do të jetë i paguar për derdhjen e energjisë në sistem , në mënyrë që të zvogëlojë mangësinë e përgjithshme , dhe të fitojë të ardhura nga ky burim.

3. Shitjet e Energjisë prej Furnizuesit Publik

3.1 Fushëveprimi i metodologjisë

Vetëm çmimet me pakicë të tatuara prej Furnizuesit Publik ndaj konsumatorëve jo të privilegjuar, i nënshtrohen rregullimit. Të gjithë çmimet e tjerë me pakicë (përfshijë komponentët që lidhen me tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes, të cilat rregullohen veçmas), lirohen prej rregullimit.

3.2 Kufizimi i ndikimeve të kundërta të reformës së çmimit të energjisë elektrike tek shtëpiakët

ZRRE është e interesuar që të sigurojë që futja e ndryshimeve në tarifat shtëpiake, të bëhet në baza graduale, dhe që tarifat të jenë të përballeshme prej konsumatorëve të varfër. Kjo do bëhet përmes një ose më shumë prej qasjeve vijuese:

- Qasja graduale dhe jo ajo e menjëhershme e tarifave që pasqyrojnë kostot për shtëpiakët, përfshirë përmes heqjes graduale të ndonjë ndër-subvencioni midis shtëpiakeve dhe konsumatorëve të tjerë; dhe
- Sigurimit të tarifës afatgjatë; dhe
- Sigurimit të energjisë elektrike të subvencionuar ndaj shtëpiakeve të përzgjedhur.

Kostoja e subvencioneve sipas dy masave të fundit, do të mbulohet ose përbrenda kategorisë së konsumatorëve si e tërë, dhe/ose prej subvencioneve që qeveria paguan ndaj KEK-ut.

3.3 Parimet e Përgjithshme

Shumica e blerjeve prej Furnizuesit Publik për t'i shërbyer konsumatorëve jo të privilegjuar, do të bëhen me çmime të rregulluar prej prodhuesve publikë, edhe pse disa mund të bëhen prej prodhuesve të tjerë. Në këtë rast, do të aplikohet një kriter blerjeje ekonomik. Kostot e këtyre blerjeve, së bashku me kosto të tjera të shoqëruara, siç janë tarifat e çekuilibruara dhe tarifat e bartjes së transmetimit dhe shpërndarjes, duhet të mbulohen prej tarifave përfundimtare të pakicës, të strukturuar në atë mënyrë që të ruajnë sinjalet e çmim-vënies të cilat pasqyrojnë kostot.

Furnizuesi Publik do të autorizohet që të taksojë një tarifë për konsumatorët, në mënyrë që të mbulojnë kostot e veta të drejtpërdrejta me pakicë, të shoqëruara me sigurimin e shërbimeve të konsumatorëve dhe tarifat e faturimit dhe njehsimit. Ai do të autorizohet gjithashtu për mbulimin e një teprice furnizimi për çdo njësi të shitur që të kompensohet për rreziqet e marra në rolin e vet si Furnizues Publik.

3.4 Kostot e blerjes së energjisë sipas MBE-ve

Furnizuesi Publik do të lejohet që të përçojë kostot aktuale të blerjeve të energjisë prej prodhuesve Publikë, nëse këto janë bërë me çmime të rregulluara për të furnizuar konsumatorët jo të privilegjuar. Kjo do të përfshijë kostot neto të çdo tarife të çekuilibruar, dhe të rregulluar sipas MNBK-së.

Është e mundshme që furnizimet në dispozicion prej prodhuesve publikë mund të mos jenë të përshtatshme për të plotësuar kërkesën prej konsumatorëve jo të privilegjuar. Në këto raste, Furnizuesit Publik do t'i kërkohej të blejë furnizime shtesë prej prodhuesve jo publikë, me çmime të parregulluar. Këto blerje do të bëhen sipas Nenit 21 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, i cili kërkon që:

- Blerjet të bëhen sipas MBE-ve, me një kohëzgjatje minimale prej një viti, dhe maksimale deri në pesë vjet.
- Çmimi dhe tarifat e tjera për blerjet e energjisë elektrike sipas MBE-ve do të specifikohen në kontratat vjetore.
- Kushtet e këtyre MBE-ve i nënshtrohen aprovimit të ZRRE-së.

Në seksionin 8 të kësaj Metodologji të Tarifave jepet më shumë udhëzim mbi parimet që qeverisin blerjet e energjisë dhe përcaktimin e të ardhurave vjetore të lejuara.

3.5 Humbjet

Humbjet gjatë transmetimit dhe shpërndarjes (që përfaqësojnë dallimin midis energjisë së njehsuar të dërguar ose importuar prej prodhuesve, dhe energjisë së shpërndarë tek konsumatorët) do të mbulojnë prej furnizuesve përmes shfrytëzimit të faktorëve të humbjes gjatë transmetimit dhe shpërndarjes (FHT dhe FSH). Shfrytëzimi i këtyre faktorëve të humbjes është përshkruar me detaje në Rregullat e Tregut.

Meqenëse kontrolli i këtyre humbjeve mbështetet me OST dhe OSSH, dhe jo me furnizuesit, ZRRE-ja do t'u kërkojë OST-së dhe OSSH-së të kompensojnë gjithë furnizuesit për kostot e humbjeve të hasura në këtë mënyrë. Kjo do të bëhet duke u kërkuar OST-së dhe OSSH-së që të blejnë këto humbje. Për arsye ligjore², furnizuesi publik do të veprojë si agjent i tyre, suke blerë humbjet dhe duke i faturuar kostot e këtyre tek OST-ja dhe OSSH-ja. Po ashtu, OST-ja dhe OSSH-ja do të lejohen të mbulojnë kostot “normale” të humbjes prej konsumatorëve.

Siç përshkruhet më poshtë, kostot e humbjeve të shkaktuara gjatë mbledhjes, i shpërndahen Furnizuesit Publik i cili ka mundësitë më të mira për t'i kontrolluar ato.

Figura 2 ilustron procesin e ngarkimit dhe kompensimit (përmes pagimit të kostove reale nga OST dhe OSSH) të pagesave për humbje

²Meqenëse prodhimi i prodhuesve publikë i rezervohet furnizuesit publik, OST-ja dhe OSSH-ja do të ishin të detyruar të kontraktojnë për importe që të mbulojnë humbjet nëse do t'u duhej t'i prokuronin direkt ato. Kjo do të ishte një problem i veçantë për OSSH-në i cili do të kishte mungesë të infrastrukturës dhe aftësive të nevojshme për këto aktivitete.




Figura 2 Pagesat për humbjet

3.6 Kostot e shitjes me pakicë

Furnizuesi Publik do të jetë përgjegjës për sigurimin e një sërë shërbimeve ndaj konsumatorëve jo të privilegjuar, përfshirë:

- Leximin e njehsorit (asetet e njehsimit do të jenë nën pronësinë e OSSH)
- Faturimin
- Inkasimi (arkëtim)
- Shërbimet e Informacionit (siç është promovimi i efikasitetit të energjisë)³
- Kosto të tjera operative

Përveç kësaj, Furnizuesit Publik do t'i kërkohet të mbajë kapital punues të mjaftueshëm për nevojat e veta, me kostot shoqëruese. Ky kapital punues do të lidhet vetëm me vonesat midis faturimit dhe mbledhjes, dhe nuk do të përfshijë ndonjë arsyetim për borxhet e këqija.

Këto kosto të shitjes me pakicë do të mbulohen përmes një arsytimi të shprehur në €konsumator. Justifikimi do të bazohet në koston mesatare të hasur për konsumator individual, pasi ka pak gjasa që të jetë e zbatueshme që të kërkohet të shpërndahen këto kosto sipas llojit dhe madhësisë së konsumatorit. ZRRE-ja synon të përcaktojë një arsyetim të përshtatshëm bazuar në

³ Kjo nuk përfshin reklamimet dhe shpenzimet e tjera të marketingut; Furnizuesi Publik ka monopol ndaj konsumatorëve jo të privilegjuar, prandaj, nuk ka nevojë që të bëjë reklama për t'i tërhequr apo mbajtur ata konsumatorë.

kostot ekzistuese të hasura prej KEK-ut dhe prej krahasimit me arsyetimet në vendet e tjera. Kjo do të përcaktohet për një periudhë të kontrollit të çmimit që përkon me atë të OST-së dhe OSSH-së. (shih seksionin 4.12.2)

Mungesat në mbledhje do të jenë përgjegjësi e Furnizuesit Publik. ZRRE-ja merr parasysh që Furnizuesi Publik do të marrë një subvencion të vjetër prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK), për të mbuluar nivelet e arsyetueshme të mos-mbledhjes, në mënyrë që të mbajë zbatueshmërinë e vet dhe të parandalojë konsumatorët “e mirë” që të paguajnë për konsumatorët “e këqij”, ndërsa vazhdon të ruajë stimujt për të përmirësuar nivelet e mbledhjes. Nëse Furnizuesi Publik i mbulon borxhet e konsumatorëve në një fazë më të vonë, kjo do të ndahet midis Furnizuesit Publik dhe BKK-së.

3.7 Teprica e furnizimit

Teprica e furnizimit kompenson Furnizuesin Publik për rrezikun që merr përsipër, fitimin mbi asetet e veta dhe koston e kapitalit punues. Këto do të jenë të kufizuara dhe ZRRE-ja përkatësisht pret që teprica e furnizimit do të jetë e vogël:

- Furnizuesi Publik është i lejuar të përcjellë kostot aktuale të blerjes së energjisë, duke përjashtuar një ekspozim të vogël për të çekuilibruar tarifat sipas MNBK-së. Për këtë arsye, përballet me rrezik shumë të vogël në lidhje me blerjen e energjisë.
- Përzgjedhja e zgjeruar e lë Furnizuesin Publik me rrezikun e hasjes së kostove të mbetura dhe/ose mbetet me konsumatorë me kosto më të larta dhe më rrezikues. Sidoqoftë, rishikimi vjetor i çmimeve dhe sasive të MBE-së, si dhe kontraktimin e propozuar prej shumë aktiviteteve të shërbimeve të konsumatorëve ndaj OSSH-së, nënkupton se ka pak gjasa që Furnizuesi Publik të hasë kosto të mëdha të mbetura. Duke lejuar përcjelljes e blerjes së energjisë dhe kostot e tjera, si dhe shpërndarjen e rreziqeve të mbledhjes tek OSSH-ja, gjithashtu nënkupton se ka pak rrezik të shoqëruar me humbjen e më shumë konsumatorëve tërheqës. Për këtë arsye, Furnizuesi Publik has një rrezik shumë të ulët kërkesë për shkak të konsumatorëve që kalojnë tek furnizuesit e tjerë.
- Po kështu, Furnizuesi Publik mund të rregullojë me shpejtësi sasinë dhe çmimin e blerjeve të energjisë për t’iu përshtatur kushteve ndryshuese të tregut, nëse konsumatorët zgjedhin të kalojnë në burime alternative lëndësh djegëse. Sërish, për këtë arsye ka shumë pak rrezik kërkesë prej konsumatorëve që kalojnë në lëndë të tjera djegëse.

Teprica e furnizimit do të shprehet si një rritje me përqindje mbi kostot e lejuara të rregulluara për blerjen e energjisë që i përcillen konsumatorit.

3.8 Tarifat përfundimtare të shitjes me pakicë

Tarifat përfundimtare të shitjes me pakicë të taksuara prej Furnizuesit Publik ndaj konsumatorit jo të privilegjuar, do të përfshijnë:

- Kostot e blerjeve me shumicë të energjisë, përfshirë tarifat e përcjella të çekuilibruara si dhe pagesat për humbjet
- Një kosto të lejuar me pakicë për konsumator, dhe një tepricë furnizimi për çdo njësi të shitur.
- Tarifat SHST dhe SHSD

Shkurtesat në arkëtim do të jenë përgjegjësi e Furnizuesit Publik.

Për këtë arsye, tarifa përfundimtare me pakicë për konsumatorët jo të privilegjuar, do të përcaktohet për të mbuluar kostot e përlogaritura në përputhje me formulën vijuese:

Ekuacioni 3-2 Të Ardhurat e Furnizuesit Publik

$$SUPL_t = \{ [PPUR_t * (1 + DLF) * (1 + TLF)] * (1 + MARG_t) \} + (RETL_t * CUST_t)$$

PPUR_t Kostot e lejuara të blerjes së energjisë për furnizimin e konsumatorëve jo të privilegjuar
DLF Faktori i humbjes së shpërndarjes (përcaktuar në përputhje me rregullat e tregut)
TLF faktori i humbjes së transmetimit (përcaktuar në përputhje me rregullat e tregut)
MARG_t Teprica e lejuar e furnizimit (%)
RETL_t kostoja e lejuar me pakicë (€/konsumator)
CUST_t numri i konsumatorëve jo të privilegjuar

Ekuacioni 3-3 Të ardhurat totale nga tarifat e pakicës

$$RTAR_t = SUPL_t + TREV_t + DREV_t + MREV_t + PASS_t$$

RTAR_t Kostot totale të mbuluara nga tarifat e pakicës
TREV_t kostot totale të mbuluara nga OST përmes tarifave të SHTS (shih Seksionin 4)
MREV_t kostot totale të mbuluara prej OT përmes tarifave të SHTS (shih Seksionin 4.13)
DREV_t Kostot totale të mbuluara nga OSSH përmes tarifave të SHSHS (shih Seksionin 0)
PASS_t Kostot neto balancuese të përcjella prej Furnizuesit Publik (shih Seksionin 2.5)

$$SUPL_t = \{ PPUR_t * (1 + MARG_t) \} + (RETL_t * NCUS_t) - SUBV_t + KPS_t$$

Ekuacioni 0-4 Kostot e Lejuara të Blerjes së Energjisë

$$PPUR_t = CPPK_t + CPPI_t - Lost - EXPT_t - ELIG_t - SUBI_t$$

Ekuacioni 0-5 Të Ardhurat Vjetore Totale të Tarifave me Pakicë

$$RTAR_t = SUPL_t + NTREV_t + NMREV_t + NDREV_t + PASS_t - SUBL_t$$

Ekuacioni 0-6 Faktori Korigjues i Furnizuesit Publik

$$KPS_t = \{ (1 + MARG_{t-1}) * (ACPPK_{t-1} + ACPPI_{t-1} - AEXPT_{t-1} - AELIG_{t-1} - ALOS_{t-1} - ASUBI_{t-1} - PPUR_{t-1}) \} + \{ (RETL_{t-1} * (ACUS_{t-1} - NCUS_{t-1})) \} - (ASUBV_{t-1} + ASUBL_{t-1} - SUBV_{t-1} - SUBL_{t-1})$$

Pritet që Furnizuesi Publik të përcaktojë një strukturë të tarifave përfundimtare të shitjes me pakicë, që ruajnë sinjale të përshtatshëm kostoje për konsumatorët. Kjo duhet të marrë parasysh çdo kriter specifik për shfrytëzimin e subvencioneve që jepen për mbrojtjen e konsumatorëve në raste sociale që mund të vendosen nga pala sigurore. Po ashtu duhet të marrë parasysh çdo nevojë për të futur gradualisht ndryshimet e tarifave. Struktura e detajuar e tarifave, duhet të propozohet nga Furnizuesi Publik për shqyrtim dhe aprovim nga ZRRE-ja. ZRRE-ja duke dhënë

aprovimi e vet, do të kërkojë që tarifat përfundimtare me pakicë, të jenë në përputhje me kërkesat e Nenit 46.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si dhe të plotësojnë kriteret vijues:

Kostot e ndara për çdo konsumator nuk janë më të larta se kostoja e të shërbyerit të atij konsumatori mbi baza individuale, dhe jo më të ulëta se kostoja e të shërbyerit të atij konsumatori mbi baza të rritjes së pagesës.

Pas futjes së rregullimeve të plota të tregut, tarifat për të mbuluar kostot e blerjes së energjisë duhet të pasqyrojnë çmimet e shumicës gjatë çdo periudhe individuale. Për konsumatorët me njehsorë të përshtatshëm, duhet të aplikohet një tarifë e veçantë për çdo orë, ose për periudhat kulmore ose jo kulmore brenda një dite, (pikut dhe jo pikut) për konsumatorët me këta njehsorë, duhet t'i kushtohet vëmendje përdorimit të tarifave sezonale, ku kostot e blerjes së energjisë ndryshojnë dukshëm midis muajve ose stinëve brenda vitit.

Tarifat për të mbuluar kostot e sigurimi të kapacitetit të mjaftueshëm të sistemit, në mënyrë që të plotësohet kërkesa maksimale, duhet të pasqyrojnë kontributin e secilit konsumator në kërkesën maksimale, si dhe ndikimin e tyre në madhësinë optimale të sistemit.

Tarifat për të mbuluar kostot e sigurimit të shërbimeve ndaj konsumatorit, duhet të aplikohen mbi baza për konsumator, duke bërë dallimin midis llojeve të konsumatorëve në rast se është e mundshme.

Në këtë moment, tarifat përfundimtare me pakicë, do të jenë uniforme për kategoritë individuale të konsumatorëve nëpër Kosovë, dhe nuk do të ketë elementë sipas vendndodhjes.

Kriteri për strukturën e tarifave të SHTS dhe SHSHS, të cilat do të përcillen në tarifat përfundimtare me pakicë, janë përshkruar veçmas në seksionet përkatëse të kësaj metodologjie.

3.8.1 Tarifa e bllokut që ngrihet

ZRRE-ja, në përputhje me Nenin 16 të Rregullit mbi Çmim-vënien, mund t'i kërkojë Furnizuesit Publik, që të fusë një tarifë ngritëse. Kjo do të aplikohet vetëm ndaj konsumatorëve shtëpiakë të cilët konsumojnë sasi të energjisë elektrike që janë poshtë një pragu/pragjeve të përcaktuara nga ZRRE-ja, ose që kanë të ardhura të vogla. Dallimi midis kostove të furnizimit të këtyre konsumatorëve dhe të ardhurave vjetore të fituara prej tyre, do të mbulohet përmes një rritjeje të tarifave për konsumatorët shtëpiakë që konsumojnë sasi të energjisë elektrike që janë përmbi kufijtë e përcaktuar nga ZRRE-ja, ose të atyre që kanë të ardhura më të larta.

Është e mundur që mund të sigurohet ndihmë tjetër ndaj konsumatorëve me të ardhura të ulëta përmes pagesave të drejtpërdrejta ndaj konsumatorëve, ose mbështetje tjetër për të cilën kanë rënë dakord Furnizuesi Publik dhe Qeveria. Kjo mbështetje nuk do të ndikojë përlllogaritjen e të ardhurave vjetore të lejuara, dhe për këtë arsye, nuk përfshihet në këtë metodologji.

4 Të ardhurat vjetore të OPST/OT

4.1 Fushëveprimi i metodologjisë

Të ardhurat vjetore të lejuara të OST-së, mbulojnë ato kosto të shoqëruara me sigurimin e sistemit të transmetimit të ndërlidhur me voltazhin e lartë brenda Kosovës, përfshirë ndërlidhësit me sistemet fqinjë, në rast se ato janë pronë e OST-së. Kjo përfshin kostot e:

- Ndërtimit të sistemit të transmetimit;
- Mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit; dhe
- Vënien në funksion të sistemit të transmetimit.

Metodologjia për përcaktimin e kostove të drejtpërdrejta të funksionit të OT në OPSTOT, përfshirë kostot e stafit, godinës dhe sistemet, është përshkruar në këtë seksion, si përbërës i veçantë.

Kjo metodologji përjashton përcaktimin e kostove të shoqëruara me operimin e vetë tregut të shumicës së energjisë elektrike, përfshirë kostot e:

- Blerjes dhe shitjes së energjisë përmes mekanizmit balancues për të ruajtur balancën e sistemit; dhe
- Blerjen e shërbimeve ndihmëse.

Metodologjia për përlllogaritjen dhe mbulimin e këtyre kostove është përcaktuar në Rregullat e Tregut. Një mekanizëm i ndarë, “mekanizmi stimulues i OST (MSST)”, prezanton stimujt me të cilët OST-ja minimizon këto kosto.

4.2 Parimet e përgjithshëm

4.2.1 Qasja e ndërtimit të blloqeve

Kostot e lejuara të OST-së do të përlllogariten duke përdorur qasjen e “ndërtimit të blloqeve”. Sipas kësaj qasjeje që më poshtë është përshkruar më detajisht, përcaktohet ndarazi një nivel efikasiteti për kostot operacionale dhe kostot kapitale të OST-së.

Ndërsa kjo qasje ka disavantazhin që nuk njih drejtpërdrejt kompromisin midis kostove operuese dhe atyre kapitale, ZRRE-ja mendon se kjo është më e zbatueshme në këtë fazë, sesa miratimi i qasjeve të bazuara në vlerësime të nivelit efikas të kostove totale. Qasje të tilla zakonisht janë të ndjeshme ndaj supozimeve të miratuara dhe definicioneve të përdorura, për të krijuar një definicion të qëndrueshëm të kostove totale me kalimin e kohës. Brenda Kosovës, këto vështirësi ekzistuese janë shuma të mëdha për shkak të qasjes së kufizuar në regjistrat e besueshëm historikë të kostove, vlerave të aseteve dhe kushteve të aseteve. Duke e pranuar këtë si dhe qasjet ndryshuese për financimin e këtyre aseteve, kjo metodologji has gjithashtu një dallim midis trajtimit të mbulimit të kostove kapitale të shoqëruara me asetet e ndërtuara gjatë ose përpara 2006, si dhe atyre të ndërtuara pas kësaj date.

Duke vendosur kontrollin e çmimeve, ZRRE-ja do të bëjë një lejim për një nivel të arsyeshëm të humbjeve të shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit, që do të mbulohej prej OST-së. Kostot e humbjeve që e tejkalojnë këtë nivel të lejuar, do të jenë përgjegjësi e OST-së.

4.2.2 Rregullimi i bazuar në stimulim

ZRRE-ja nuk propozon që të marrë pjesë në analiza të shpeshta dhe të detajuara "hap-pas hapi" të arsyeshmërisë së niveleve ekzistues të kostove, proces të cilin ZRRE-ja e konsideron si jo efektiv, duke qenë se botëkuptimi i ZRRE-së është shumë më i kufizuar ndaj kostove të OST-së në lidhje me njohurinë e menaxhimit të tij, dhe për të përfshirë ZRRE-në në mikro-menaxhimin e OST-së, që nuk bën pjesë në funksionet e rregullatorit. Në fakt, ZRRE-ja do të miratojë një qasje të bazuar në stimulimin për të rregulluar kostot e OST-së.

Sipas kësaj, ZRRE-ja do të përcaktojë të ardhurat e lejuara për OST-në, për një periudhë kontrolli të çmimeve, që zgjat një sërë vitesh (si në qasjet e mirënjohura të çmimit tavan dhe të ardhurave vjetore tavan), bazuar në parashikimin e niveleve efikase të kostove gjatë kësaj periudhe. Këta kufij do të përcaktohen në kushte të vërtetë. Të ardhurat vjetore të lejuara, do të indeksohen brenda kësaj periudhe me anë të disa masave të ndryshimeve në kostot e hyra të OST-së. Kjo jep formulën e përgjithshme në vijim, për të përcaktuar të ardhurat vjetore të lejuara për OST-në gjatë çdo viti të periudhës së kontrollit të çmimeve:


$$REV_t = REV_{t-1} * (1 + CI_t - X)$$

REV_t	<i>të ardhurat vjetore të lejuara (të shprehura si të ardhura vjetore maksimale, të ardhurat vjetore mesatare të njësisë, ose koshi i tarifave)</i>
CI_t	<i>treguesi i ndryshimit në kosto të të hyrave (%)</i>
X	<i>ndryshimi i vërtetë në të ardhurat vjetore të lejuara (%) – përcaktuar nga ZRRE</i>

Në fund të periudhës së kontrollit të çmimeve, ZRRE-ja do të shqyrtojë të gjithë kostot reale kundrejt niveleve të lejuar, dhe do të rivendosë pikën filluese të kontrollit të çmimeve, në mënyrë që të marrë parasysh dallimin midis tyre. Pas kësaj, do të fillojë një periudhë e re e kontrollit të çmimeve.

Ky proces është ilustruar në figurën 3, më poshtë.

Figura 3 Ilustrimi i kontrollit të çmimit bazuar në stimulimin



Kjo qasje siguron stimuj të fortë ndaj OST-së për të ulur kostot në mënyrë shumë të shpejtë, në nivele të efikasitetit të “vërtetë”. Në rast se mund të ulë kostot poshtë nivelit të parashikuar prej ZRRE-së, në vendosjen e të ardhurave vjetore të lejuara, atëherë OST-ja mund të mbajë përfitimet në formë të fitimeve të rritura, deri në shqyrtimin tjetër të çmimeve, kur ZRRE-ja do të rregullojë kostot e lejuara për të pasqyruar nivelin real të arritur. Po kështu, në rast se kostot e kalojnë nivelin e parashikuar, atëherë OST-ja do të shohë që fitimet e saj janë ulur. Në të njëjtën mënyrë, shqyrtimet vjetore të kostove të lejuara nuk lejojnë që OST-ja të mbajë përfitimet prej efikasitetit të rritur, dhe në këtë mënyrë, heqin stimujt e saj për të arritur këtë.

Shfrytëzimi i periudhës së kontrollit shumëvjeçar të çmimeve, ofron përfitime për OST-në dhe konsumatorët, duke krijuar çmime më të qëndrueshme dhe të parashikueshëm. Në një ambient si Kosova, kjo ka rëndësi të veçantë sepse është me rëndësi jetike që të inkurajohen investimet e reja në industrinë e energjisë elektrike.

ZRRE-ja njeh se pasiguritë e trashëguara në ambientin aktual Kosovar, vendosin rreziqe të mëdha mbi OST-në dhe mbi konsumatorët, përfitimet e të cilave mund të jenë jashtëzakonisht të lartë ose të ulët për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të OST-së, dhe nuk mund të parashikohen apo të maten si duhet në kohën e vendosjes së kontrollit të çmimit. Për të mbrojtur kundër kësaj, ZRRE-ja gjatë periudhës së kontrollit të parë të çmimit, do të aplikojë “rihapjen”, sipas së cilës, në rast të rrjedhëve të jashtëzakonshme, do të ndodhë një shqyrtim i përkohshëm i kontrollit të çmimit.

Struktura e detajuar e formulës së kontrollit të çmimit, kohëzgjatja e vet, dhe zgjedhja e indeksit të kostos si dhe kushtet për rihapjen, janë paraqitur në seksionet vijues.

4.2.3 Kostot Operative

Regjistrat ekzistues për shpenzimet operuese, janë të paplotë dhe nuk mund të besohen. Për këtë arsye, ZRRE-ja propozon të fokusohet mbi vendosjen e caqeve reale për përmirësime në efikasitetin operues të OST-së, pas periudhës së parë të kontrollit të çmimit. Në fund të kësaj periudhe, me përmirësimin e regjistrave të kontabilitetit dhe me stimujt e siguar prej kontrollit të çmimit nga menaxhimi i OST-së për rritjen e efikasitetit, do të vihen në dispozicion informacione më të kujdesshme mbi nivelet efikase të shpenzimeve.

4.2.4 Kostot e Aseteve para 2006

Asetet ekzistues të OST-së në 2006, janë ndërtuar ose përpara konfliktit të fundit, me hua të shoqëruara që nuk janë servisuar prej OST-së, ose janë ndërtuar më pas apo janë rehabilituar duke përdorur financimin e donatorëve. Në të dy rastet, OST-ja nuk ka tarifa financuese të

shoqëruara me këto asete. Përveç kësaj, kushtet aktuale dhe vlerësimi i duhur i këtyre aseteve, është disi i paqartë.

Në këtë situatë, është e papërshtatshme të lejohet që OST-ja të fitojë një normë komerciale kthimi mbi asetet, të cilën nuk ka nevojë ta financojë. Gjithashtu është e vështirë të përcaktohet një normë e lejuar e përshtatshme e zhvlerësimit, kur vlera dhe kushtet e këtyre aseteve jo gjithmonë janë të njohur.

Për këtë arsye, ZRRE-ja propozon të lejojë OST-në që të mbulojë kostot reale të shoqëruara me blerjen dhe mirëmbajtjen e këtyre aseteve, përfshirë:

- Kostot reale të financimit të këtyre aseteve (për shembull, hua të mëdha të donatorëve); dhe
- Kostot e mirëmbajtjes së këtyre aseteve në gjendje të mirë pune, përmes një tarife të rinovimit të infrastrukturës.

Nëse kjo situatë ndryshon në të ardhmen, për shembull si rezultat i marrjes së përgjegjësisë së OST-së për shërbimin e borxheve të shoqëruar me këto asete ose nëse qeveria e Kosovës është pronari i OST-së dhe i kërkon që të paguajë një ‘tarifë’ për shfrytëzimin e aseteve të veta, atëherë ZRRE-ja do të lejojë mbulimin e kostove financuese të arsyeshme që rrjedhin prej kësaj. Kjo është në përputhje me parimin se shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit, janë përfituesit kryesorë të këtyre aseteve, dhe për këtë arsye, priten që të mbajnë kostot e sigurimit të tyre.

4.2.5 Kostot e Aseteve pas 2006

Asetet e ndërtuara pas 2006, do të ndryshojnë nga asetet ekzistuese në atë që kostot e tyre do të jenë të ditura, dhe që OST-ja do të pritët t’i financojë, së paku pjesërisht, prej burimeve komerciale. Prandaj është e mundshme që të miratohet një qasje më ‘konvencionale’ për të inkorporuar kostot e këtyre aseteve në kosto të lejuara të OST-së, dhe njëkohësisht, të krijohen stimulime që OST-ja të financojë këto asete me kostot më të ulëta.

Për këtë arsye, ZRRE-ja propozon të lejojë OST-në që të mbulojë shpenzimit e aseteve të reja përmes:


- Një tarifë zhvlerësimi që përfaqëson kthimin e investimit fillestar të këtyre aseteve me kalimin e kohës; dhe
- Një kthim të lejuar mbi këto asete, duke pasqyruar vlerësimin e ZRRE-së mbi mesataren e Ponderuar të kostos së kapitalit (MPKK) të OST-së.

4.3 Qasja e ndërtimit të blloqeve

Sipas qasjes së ndërtimit të blloqeve për përcaktimin e kostove dhe të ardhurave vjetore për OST-në, kostot e lejuara të operimit, kostot e shoqëruara me asetet para 2006 dhe kostot e shoqëruara me asetet e pas 2006, (zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar) përcaktohen veçmas dhe më pas mblidhen për të mbërritur tek kostot totale të lejuara.

Kjo është ilustruar në Figurën 4.

Figura 4. Qasja e ndërtimit të blloqeve për kostot e lejuara të OST-së



Për qëllimin e këtyre përlllogaritjeve, kostot e shoqëruara me OST-në dhe funksionet e saj, do të identifikohen ndarazi, përpara se të kombinohen këto për mbulimin e kostove përfundimtare të lejuara gjatë periudhës së kontrollit të çmimit.

Vlera aktuale e të ardhurave të lejuara mbi periudhën e kontrollit të çmimeve, do të jetë e njëjtë me vlerën aktuale të kostove të lejuara, të përlllogaritura si më sipër. Sidoqoftë, në vite të veçantë, vlera e të ardhurave të lejuara, mund të jetë më e madhe ose më e vogël se vlera e kostove të lejuara, në mënyrë që të lejojë një profil më të qëndrueshëm të çmimeve për konsumatorët. Ky proces është përshkruar me më shumë detaje në seksionet vijuese.

4.4 Përcaktimi i Shpenzimeve Operative

ZRRE-ja është e kujdesshme që të sigurojë se shpenzimet operative të futura në të hyrat e lejuara të OST-së janë të arsyeshme dhe efikase. Njëkohësisht, ZRRE-ja njih vështirësitë në përcaktimin efikas të këtyre shpenzimeve në nivel të duhur, në një ambient ku të dhënat nga kontabiliteti janë të paplota dhe me besueshmëri të limituar dhe ku shpenzimet e tanishme mund të kufizohen nga problemet e rrjedhjes së parasë dhe ku nuk ka krahasues të dukshëm për ndërmarrjet e rregulluara.

Duke e marrë parasysh atë që është përmendur më lart, ZRRE-ja propozon që të pranojë nivelin ekzistues të kostove operative gjatë kontrollit të parë të çmimit për OST-në. ZRRE-ja më pas do të definojë një cak për zvogëlimin e këtyre kostove operative duke u bazuar në nivelin e përmirësimit të produktivitetit të treguara nga ndërmarrjet e rregulluara të rrjete ndërkombëtare.

Gjatë periudhës së parë të kontrollit të çmimit, ZRRE-ja pret që sasia dhe cilësia e të dhënave mbi kosto operative të OST-së, do të përmirësohen dukshëm. ZRRE-ja gjithashtu pret që adaptimi i kontrollit të çmimit të bazuar në stimulim, do të inkurajojë OST-në që të zbulojë nivelin e “vërtetë” të shpenzimeve. Në vënien e të ardhurave të lejuara për kontrollin e dytë dhe vijues të çmimit, ZRRE-ja pret t’i shfrytëzojë këto të dhëna më të mira për të bërë krahasime të shpenzimeve të OST-së dhe OST-ve të tjera ndërkombëtare për të ndihmuar në formimin e një gjykimi në nivelin e arsyeshmërisë së tyre.

Gjatë periudhës së kontrollit të parë të çmimit, ZRRE-ja do të zhvillojë qasjen e saj ndaj këtij krahasimi, duke u bazuar në përvojën dhe metodologjinë e zhvilluar nga rregullatorët e tjerë të BE-së.

4.5 Përcaktimi i BAR

Baza e Aseteve të Rregulluar (BAR), paraqet shumën e kapitalit të investuar nga OST-ja, në të cilën lejohet rendimenti (kthimi). Kjo përbëhet prej tre elementeve:

- BAR hapës apo fillestar.
- Investimet kapitale shtesë në BAR.
- Zhvlerësimi i asetëve të larguara prej BAR.

Për përcaktimin e BAR, përdoren rregulla të veçanta, ku asetet e pas-2005, janë të financuara nga kreditë me koncesion dhe nga donacionet e donatorëve. Këto janë diskutuar në seksionin 4.6 (që ka të bëjë me MPKK).

4.5.1 BAR hapës apo fillestar

Meqë ZRRE-ja propozon të lejojë mbulimin (kthimin) e shpenzimeve të financimit që lidhen me asetet e para-2005 përmes rregullimit përcjellës, dhe të lejojë një pagesë për ripërtëritjen e infrastrukturës së bazuar në shpenzimet e mirëmbajtjes së këtyre asetëve në gjendjen e tyre aktuale, por jo të përfshijë këto asete në BAR. Në këtë mënyrë, do të mund t’ua dyfishonin vlerën, duke lejuar OST-në që të përvetësojë rendimentin dhe zhvlerësimin (amortizimin) e këtyre asetëve, ndërkohë që nga ana tjetër merr të ardhurat vjetore për mbulimin e kostove të borxhit dhe të mirëmbajtjes së këtyre asetëve.

Vlera e asetëve fikse të përfshira në BAR hapës për OST-në, do të bëhet zero (barazohet) duke filluar nga 1 janari 2006.

Në mes të periudhave të kontrolleve të çmimeve, BAR fillestar duhet të azhurohet në përputhje me masën e ndryshimeve reale në vlerën e asetëve (p.sh. indeksi i përgjithshëm i inflacionit). Kjo do të bëjë që vlera reale e BAR-it të mbetet konstante, ndërsa rendimenti dhe shuma e lejuar për zhvlerësim, të pasqyrojnë siç duhet shpenzimet e këtyre asetëve.

4.5.2 Shpenzimet kapitale

ZRRE-ja do të rishikojë projektet e propozuara investuese rast-pas-rasti. Ky rishikim do të marrë parasysh:

- Nëse ka nevojë të dukshme për projekte, dhe në veçanti, nëse nxiten politikat e qeverisë duke pasur parasysh ofrimin e shërbimeve universale dhe të sigurta.
- Përfitimet e projektit, që kanë të bëjnë me kostot e tij të vlerësuara.
- Urgjenca e projektit dhe nëse ka ndonjë ndikim negativ të madh, apo në rast se shtyhet për periudhën e ardhshme të kontrollit të çmimit.
- Arsyeshmërin e kostove të projektit.

Kur bëhet vlerësimi i arsyeshmërisë së shpenzimeve, ZRRE-ja në përgjithësi nuk propozon të ndërmerren studime të detajuara teknike mbi projektet. Në vend të kësaj, ZRRE-ja do të bëjë krahasimin e kostove të propozuara të projekteve, kundrejt atyre të regjistruara historikisht në Kosovë dhe atyre që shihen në shtetet me të cilat do të krahasohet, duke shikuar kostot e vlerësuara të njësisë (si kostot për km) dhe kostot e vlerësuara lidhur me prodhimin (si kostot për konsumatorë ose MW të fuqisë). ZRRE-ja pranon se do të nevojiten elemente të rëndësishme të gjykimit, por është skeptike se do të aplikohet ndonjë rregull mekanik.

Kur është miratuar një projekt investimi për përfshirjen në kostot e lejuara që do të mbulohen sipas kontrollit të çmimit, atëherë ZRRE-ja do të presë që të ndërmerret një investim i tillë.

Nëse një investim nuk është përmbushur brenda afatit kohor të aprovuar në kohën e përcaktimit të kontrollit të çmimit, ZRRE-ja do ta përjashtojë këtë prej hapjes së BAR-it për periudhën vijuese të kontrollit të çmimit, duke e përfshirë vetëm në atë periudhë kur kryhet, përveç për disa projekte madhore shumëvjeçare ku mund të përfshihen kostot e investimeve nëse hasen, duke marrë parasysh nevojat financuese thelbësore. Eriudha aktuale të kontrollit të çmimit do të radhiten në bazë prioriteti, duke marrë parasysh përfitimet që ofrohen lidhur me kostot e tyre dhe të ndonjë vazhdimi të nevojshëm, ku projektet e mëvonshme do të varen nga përfundimi i suksesshëm i projekteve të mëhershëm. Kjo radhitje do të përdoret për të përcaktuar se cilat projekte do të ndërmerren në rast se kërkohet që, në pajtim me limitin e përballeshëm, disa projekte të shtyhen. Përveç kësaj, ZRRE-ja do të rregullojë kostot e lejuara për periudhën pasuese të kontrollit të çmimit në rënie, që të mbulojë ndonjë të ardhur të përfituar nga OST-ja në lidhje me këtë investim, përmes rendimentit të lejuar dhe lejimit për zhvlerësim në periudhën kur sapo ka përfunduar kontrolli i çmimit (proces i quajtur “zhvatje”).

OST-ja do të mbajë përgjegjësinë të bëjë këtë investim dhe ZRRE-ja nuk do të aprovojë ndonjë ngritje të kostove të lejuara për këtë projekt investimi nën kontrollet e ardhshme të çmimit. ZRRE gjithashtu do të presë që OST-ja të shpërndajë të mirat që i destinohen investimit (p.sh. në formë të humbjeve të reduktuara) po qe se është apo nuk është ndërmarrë. Kjo lë përgjegjësi për shpërndarjen e investimeve në kohë dhe përbrenda buxhetit në OST.

Anasjelltas, ZRRE-ja nuk do të reduktojë të ardhurat e lejuara të së ardhmes ku OST-ja ka kompletuar një projekt investimi për më pak se shpenzimet e lejuara në kontrollin e çmimit. OST-ja do të jetë në gjendje të mbaj kursime pasuese si një stimulim për përmirësime efikase. ZRRE-ja do të shfrytëzojë evidencën që OST-ja të mund të shpërndajë projekte me shpenzime më të ulëta sesa ato të parashikuara në vlerësimin e arsyeshmërisë së kostove të projekteve investuese të propozuar në rishikim në të ardhmen – kështu duke i lejuar konsumatorëve të përfitojnë nga këto kursime në të ardhmen.

Në këtë moment, ZRRE-ja nuk propozon të përdoret asnjë lloj optimizimi ose testi “të përdorshëm dhe të dobishëm” për investimet përderisa këto do të jenë kompletuar dhe inkorporuar në BAR. Kjo do të rrisë në masë të konsiderueshme rreziqet rregullative të lidhura me investimet përderisa shpërndahen vetëm te përfitimet e kufizuara. Sido që të jetë ZRRE rezervon të drejtën të paraqesë një test rregullativ të kësaj forme në të ardhmen me sigurime të përshtatshme për mbrojtjen e investimeve ekzistuese.

4.5.3 Amortizimi

Në përcaktimin e zhvlerësimit të lejuar, ZRRE propozon të theksohet thjeshtësia dhe konsistenca me praktikën ekzistuese të kontabilitetit për më shumë efikasitet ekonomik por më komplekse dhe me më pak qasje njohëse. Andaj do të përdoret metoda direkte e zhvlerësimit . Jeta mesatare e asetëve do të shfrytëzohet bazuar në vlerën e supozuar të mesatares së Ponderuar të jetës së asetëve të ndryshme të prezantuara nga projektet investues te miratuara.

4.6 Përcaktimi i MPKK

MPKK i shfrytëzuar për të kalkuluar kthimin e lejuar prezanton koston e vlerësuar të financimit për OST. E cila është një mesatare e Ponderuar e kostos së financimit nga borxhi dhe ekuiteti, ku secila nga këto shprehet si një normë pa-rrezik (duke prezantuar koston e financimit për asetet pa rrezik), plus premia e rrezikut që prezanton rreziqet shtesë në huamarrjen nga OST-ja ose blerjen e ekuitetit në OST.

Kjo shprehet sipas ekuacionit vijues.

$$MPKK = (1 - g) * (r_f + ERP_i) + g * (r_f + DRP_i)$$

<i>MPKK</i>	<i>Mesatarja e Ponderuar e koston së kapitalit</i>
<i>g</i>	<i>Leverazhi (koeficienti) i borxhit</i>
<i>r_f</i>	<i>Norma pa-rrezik</i>
<i>ERP_i</i>	<i>Premia e rrezikut të ekuitetit për kompaninë i</i>
<i>DRP_i</i>	<i>Premia e rrezikut të borxhit për kompaninë i</i>

Fitimi i përlllogaritur në krahasim me koston aktuale të financimit përdoret për të ofruar stimulim për OST-në që të kërkojë financim komercial me një kosto nën MPKK ne përcaktuar nga ZRRE-ja për ta ruajtur ndryshimin. Kjo do t’i ofrojë dëshmi ZRRE-së për kostot reale të financimit të OST-së të cilat mund të shfrytëzohen për të rregulluar në mënyrë të përshtatshme MPKK-in e lejuar në periudha të ardhshme të kontrollit të çmimit.

4.6.1 Asetet e financuara në baza komerciale

ZRRE propozon që, për asetet e financuara në baza komerciale për përcaktimin e MPKK të aplikohet qasja si në vijim:

- Norma pa-rrezik do të përcaktohet në afat të gjatë nga rendimenti, obligacionet e emëruara si Euro të lëshuara nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE).
- Kjo do të rregullohet nga rreziku i shtuar në vend, që pasqyron rrezikun shtesë të investimit në Kosovë në raport me atë të shteteve anëtare të BE-së.

- Premia e rrezikut të kompanisë lidhur me huadhënien OST-së më shumë se sa Qeveria e Kosovës do të përcaktohet në bazë të evidencës nga krahasuesit ndërkombëtarë.
- Premia e rrezikut lidhur me investimet e kapitalit të OST-së do të kalkulohet duke përdorur modelin e vënies së çmimit të asetit kapital (CAPM-Capital Asset Pricing Model) dhe të dhënat ndërkombëtare krahasuese. ZRRE-ja pranon kufizimet e këtij modeli por në përputhshmëri me rregullatorë të tjerë ndërkombëtarë, gjithashtu e konsideron si një qasje praktike më të mirë dhe teorikisht të mbështetur për momentin.
- Raporti i vlerësuar i borxhit ndaj ekuitetit, i cili përdoret në përlllogaritjen e MPKK-së, do të bazohet në rregullimet e pritura financiare të së ardhmes dhe jo sipas raportit historik.
- MPKK-ja do të përlllogaritet në baza të para-tatimit, duke i lënë OST-së detyrim për tatim pa ndonjë lejim specifik të bërë për këto në shpenzimet e lejuara.

4.6.2 Asetet e financuara nga donatorët pas 2006

Vështirësia paraqitet kur asetet e reja janë financiar nga donacionet dhe nga huadhëniet koncesionare të ofruara nga donatorët ose nga buxheti i qeverisë kosovare. Duke lejuar OST të përfitojë një normë komerciale të kthimit në këto asete, do të qojë drejt një përfitimi të kthimit që tejkalon kostot ekzistuese financiare. Kjo gjithashtu do të jetë kundër vullnetit të donatorëve në ofrimin e normave financiare nën normat komerciale – që do të thotë se konsumatorët kosovarë do të fitojnë prej kursimeve për OST-në.

Për të zgjidhur këtë, për asetet e financuara nga të ardhurat e donatorëve ZRRE-ja do të:

- Ndajë BAR-in e shfrytëzuara për qëllime të përlllogaritjes së rendimentit të pranuar dhe zhvlerësimit.
- Përfshijë asetet e financuara nga donatorët në BAR të shfrytëzuara për kalkulimin e rendimentit të pranuar me një vlerë të rregulluar “në përpjesëtime ” për dallimin në mes të kostove në bazën e tyre financiare dhe MPKK komercial të zhvilluar nga ZRRE-ja. P.sh. nëse MPKK komercial është përcaktuar 10% dhe një aset është financiar nga kredia koncesionare me normë interesi prej 2%, do të përfshihej në BAR në 20% (= 2%/10%) të kostove të lejuara. Rendimenti i lejuar që rezulton në këtë aset është i qëndrueshëm me koston e financimit të tij në OST.
- Përfshijë asetet e financuara nga donatorët në BAR e përdorura për kalkulimin e zhvlerësimit të pranuar në kostot e plotë të lejuar. Lejimi I zhvlerësimit që rezulton është i qëndrueshëm me koston e “konsumimit” të këtyre aseteve gjatë tërë jetës së tyre në mënyrë që të siguroj shërbimin rregullativ.

Kjo qasje është e lehtë për t’u aplikuar dhe shmang kërkesat për krijimin e shumë klasave të aseteve varësisht nga burimi dhe kostoja e financimit, të cilat do t’i shtonin kompleksitet procesit raportues të rregullatorit.

4.7 Bartja e shpenzimeve të para-2006

Kostot e shoqëruara me asetet e ndërtuara para 2006 do të përçohen në formën e pagesave financiare ekzistuese të lidhura me këto asete dhe me shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre në gjendjen reale. Ato të parat do të përcaktohen në bazë të pagesave që do të bëhen në periudhën vijuese të kontrollit të çmimit, për t’i rregulluar këto në terme reale. Ndërsa ato të fundit do të rigjenerohen përmes një pagese të ripërtëritjes së infrastrukturës (tarifat e mirëmbajtjes). Kjo

pagesë do të bazohet në mesataret historike të kostove për mirëmbajtjen e këtyre aseteve duke ditur se kostot historike mund të jenë një udhërrëfyes jo i saktë për kostot e së ardhmes për shkak të ndikimit të detyrimeve të rrjedhjes së parasë në vitet e mëparshme, mesatare e kostove të parapara për mirëmbajtjen e këtyre aseteve. Këto pagesa nuk do të mbulojnë shpenzimet e renovimeve të mëdha ose rehabilitimeve të aseteve ekzistuese, që do të trajtohet si një projekt investues i ri dhe do të rregullohet në përputhje me rrethanat.

4.8 Humbjet

Kostove të lejuara të përcaktuara në këtë mënyrë, ju shtohet shumë e lejuar e humbjeve të arsyeshme të transmissioinit. Kjo shumë e lejuar shfrytëzohet nga OST-ja që të kompensojë furnizuesit për kostot e humbjeve të përcaktuara nën Rregullat e Tregut, siç diskutohet në Seksionin 3.5 dhe siç është ilustruar në Figurën 2. Vlera e lejuar, së paku fillimisht, do të kalkulohet si çmim stimulues i tregut në çdo orë, shumëzuar me sasinë e energjisë së parashikuar që hyn në transmetim në atë orë, dhe shumëzuar me nivelin e humbjes së lejuar që aplikohet në atë orë. Në fund të çdo viti do të bëhet një krahasim në mes të të ardhurave të rigjeneruara përmes kësaj qasjeje dhe atyre që do të ishin rigjeneruar nëse do të ishte bërë kalkulimi duke përdorur çmimet reale të tregut dhe sasinë e energjisë, përderisa vazhdohet të aplikohen nivelet e lejuara të humbjeve më parë se nivelet reale të humbjeve, në çdo orë. Ndryshimi do të aplikohet si një faktorë korigjues për të ardhurat e lejuara të OST në vitin vijues. Ky proces do të administrohet përmes mekanizmit të marrëveshjes të përshkruar në Rregullat e Tregut (përfshirë çdo rregull kalimtar që do të aplikohet).

Humbjet e lejuara do të përfshijnë humbjet që kanë të bëjnë me transitin e energjisë përgjatë rrjetit kosovar. Kostot e shoqëruara me këto humbje transite, do të mbuloohen gjatë vitit vijues prej pagesave për shfrytëzimin e rrjetit të OST-së për transitin ndërkombëtar të energjisë elektrike sipas Mekanizmit Kompensues Ndër-OST (MKN). Pagesat neto të marra sipas MKN-së do të përçohen tek konsumatorët, të cilët do të kompensohen për humbjet në transit që janë paguar gjatë vitit të mëparshëm.

Formula për përcaktimin e humbjeve të lejuara që do të përfshihet në kontrollin e çmimit shprehet si vijon.

Ekuacioni 4-1 Shuma e lejuar e humbjeve të Transmissioinit

$$TLOS_t = (TALO_t * FGEN_t + ILOS_t * TSIT_t) * FWEP_t + TLAD_t$$

$TLOS_t$	Humbjet e lejuara të transmissioinit të përfshira në kontrollin e çmimit (€)
$TALO_t$	Niveli i lejuar i humbjeve (%) – mesatarja e Ponderuar përgjatë vitit nga furnizimi i parashikuar nga prodhimi dhe importet që hyjnë në rrjetën e transmissioinit çdo orë
$FGEN_t$	Furnizimi i parashikuar nga prodhimi dhe importet që hyjnë në rrjetën e transmissioinit (GWh)
$FWEP_t$	Mesatarja e parashikuar e çmimit të elektricitetit të tregut me shumicë (€/MWh) – mesatarja e Ponderuar përgjatë vitit nga furnizimi i parashikuar nga prodhimi dhe importet që hyjnë në rrjetën e transmissioinit çdo orë
$ILOS_t$	Niveli i parashikuar i humbjeve (%) që rezultojnë prej rrjedhjeve të energjisë – mesatarja përgjatë vitit
$TSIT_t$	Vëllimi i parashikuar i rrjedhjeve të energjisë në vit (GWh)

$TLAD_t$ Rregullimi për korigjimin e dallimeve në mes të shumës së lejuar të humbjeve të humbjeve në vitin vijues bazuar në parashikimin e prodhimit, importet dhe çmimet e tregut dhe prodhimi ekzistues, importet dhe çmimet e tregut. Kalkuluar si më poshtë:

Ekuacioni 4-2 Faktori Rregullues i Humbjeve të Transmisionit

$$TLAD_t = [(TALO_{t-1} + ILOS_t * (AGEN_{t-1} * AWEP_{t-1}) - (TLOS_{t-1} - TLAD_{t-1})\zeta * (1 + INTR_t)]$$

$AGEN_t$ Furnizimi ekzistues nga prodhimi dhe importet që hyjnë në rrjetën e transmisionit (GWh)

$AWEP_t$ Mesatarja ekzistuese e çmimit të elektricitetit të tregut me shumicë (€/MWh) – mesatarja e Ponderuar përgjatë vitit nga furnizimi i parashikuar nga prodhimi dhe importet që hyjnë në rrjetën e transmisionit çdo orë

$INTR_t$ Norma e aplikuar e interesit (% e përcaktuar nga ZRRE) – kjo komponson ndërmarrjen/konsumatorin nga shpenzimet shtesë të interesit/të ardhurat e kaluara të interesit që rezultojnë me vonesë të aplikimit të korigjimit

Niveli i humbjeve të lejuara do të bazohet në nivelet e humbjeve historike, rezultatet e modelimit të sistemit të transmisionit, duke marr parasysh ndikimet në humbjet e investimeve të reja dhe duke ndryshuar rrjedhën e energjisë dhe duke krahasuar me nivelet e humbjeve të regjistruara në sistemet e tjera të transmisionit.

4.9 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e Përfshiuara

Kalkulimi i kostove të lejuara dhe përcaktimi i të hyrave të lejuara në kontrollin e çmimit përjashton të ardhurat nga burimet jo rregullative siç janë: qeradhënia e zyra për shkaqe komerciale, pagesat për shfrytëzimin e pajisjeve shëndetësore dhe sportive etj. Menaxhimi i këtyre shpenzimeve afariste dhe të ardhurave prej tyre është çështje e OST-së.

Përlllogaritja e kostove të BAR përjashton asete të reja të rrjetit të financuara nga pagesa për kyçe dhe kjo do të nënkuptonte lejimin e OST që të realizon rendimentin nga asetet për të cilat nuk ka paguar. Nëse, në të ardhmen asetet e rrjetit (si të kundërta me çmimet e qasjeve direkte) fillimisht të financuara nga pagesat në marrëdhënie zëvendësohen atëherë ato do të hyjnë në BAR.

Ndërlidhësit përfshihen në BAR. Sidoqoftë, të ardhurat nga ankandet e kapacitetit të ndërlidhësve të ndërmarra në përputhje me mekanizmin për menaxhim të kongestionit janë të lidhura në mënyrë zinxhirore me të ardhurat e tjera të rregulluara. Në vend të kësaj, ato janë të akumuluar në një fond të veçantë. Në përputhje me këto principe të paraqitura në Rregulloren e BE mbi shkëmbimet ndër kufitare (cross-border exchanges⁴), të ardhurat do të lirohen nga ky fond në një bazë vjetore siç është aprovuar nga ZRRE-ja, në mënyrë që të:

- Garantojë disponueshmërinë reale të shpërndarjes së kapacitetit të linjës ndërlidhëse; dhe

⁴ Rregulli (EC) No. 1228/2003 mbi kushtet për Qasje në Rrjet për Shkëmbim Ndërkufitar të Energjisë Elektrike

- Garantojë investimet që mirëmbajnë apo ngrenë kapacitetet ndërlidhëse, kostot e të cilave janë subjekt për rishikim dhe aprovim nga ZRRE për investimet e propozuara.

Nëse të ardhurat e fituara përmes mekanizmit për menaxhim të kongestionit tejkalojnë shumën e kërkuar për këto kushte, atëherë teprica do të ruhet për vitet e ardhshme.

Nëse të ardhurat lirohen nga fondi për menaxhim të kongestionit, këto do të kompensohen ndaj të ardhurave të lejuara të OST-së në po atë vit, duke reduktuar kështu pagesat për shfrytëzim të sistemit të transmetimit (SHTS).

OST-ja do të përfitojë ose paguajë shuma sipas Mekanizmit të Kompensimit të Ndër-OST (MKN). Pagesat e pritura përlllogariten me paradhënie për çdo vit, duke përdorur të dhëna historike në rrjedhat⁵ neto të energjisë elektrike përreth kufijve.

Paqartësitë aktuale mbi rrjedhjet e ardhshme të tranzitit dhe pagesat e ITC nënkuptojnë se nuk është e mundur që ZRRE-ja të parashikojë rrjetin e të ardhurave të përfituara nga burimi i OST-së gjatë periudhës së kontrollit të çmimit. Në vend të kësaj, së paku për periudhën fillestare të kontrollit të çmimit, ZRRE-ja do të lejojë bartjen e të ardhurave reale të rrjetit të përfituara prej ITC-së deri tek shfrytëzuesit e sistemit të , bazuar në vlerat ex-ante (para) të vlerësuara në përputhje me kërkesat e ITC-së, dhe me një faktor korigjues për të marrë parasysh rregullimet ex-post (pas) të pagesave të ITC-së. Duke ditur se ITC-ja përdor të dhëna historike dhe kosto standarde dhe metodologji të përlllogaritjes në përputhje me të gjitha OST-të pjesëmarrëse në përcaktimin e pagesave të ITC-së, mundësitë e një OST-je individuale për të ndryshuar nivelin e këtyre pagesave, janë shumë të kufizuara. Prandaj humbja e stimulimit prej bartjeve të lejuara të këtyre të ardhurave, nuk konsiderohet të jetë shqetësuese.

4.10 Mekanizmi Simulues i Sistemit të Transmetimit (MSST)

MSST-ja i ofron OST-së stimulim, kostot e veprimeve të ndërmarra për sigurimin e balancimit të kërkesave dhe furnizimin e sistemit. OST-ja tregton me gjeneratorët përmes mekanizmit balancues për të blerë dhe shitur energji për këtë qëllim, dhe duke përzgjedhur ofertat e parashtruara nga gjeneratorët. Përveç kësaj, OST-ja mund të kontraktojë me gjeneratorët për energji rezervë. Kjo shpërndahet përmes mekanizmit balancues, por paguhet me çmimin ushtrues të përfshirë në kontratë. Sipas kontratës prodhuesi do të marrë një pagesë për disponueshmëri.

Sipas MSST-së, OST-ja do të parashikojë kostot e veprimeve të balancuara, shumën e kostove të tregut përmes mekanizmit balancues, dhe kontratat për energji rezervë për vitin që vjen. Ky parashikim do të rishikohet nga ZRRE-ja, e cila do të vendosë nivelin e kostove objektive për veprimet balancuese të ndërmarra nga OST-ja. Nëse kostot e OST-së janë nën këtë objektiv, do të mund të ruhet një pjesë e kursimeve që rezultojnë, me një limit për maksimumin e kursimeve të lejuara, dhe pjesa tjetër do të mund t'iu kthehet konsumatorëve përmes një reduktimi në të ardhurat e lejuara në vitet. Nëse shpenzimet e OST-së e kalojnë këtë objektiv, do të aplikohet një pjesë ekuivalente e ngritur. ZRRE-ja gjithashtu do të përcaktojë normën përkatëse të ndaljes dhe kufizimet e larta dhe të ulëta në diferencën kostove ekzistuese dhe objekteve të mbajtura nga OST-ja gjatë çdo viti.

⁵Volumet e tranzitit janë të llogaritura si importet totale minus eksportet totale të vendit.

Formula e MSST-së për përcaktimin e kostove të balancimit të rigjeneruara nga shfrytëzuesit e sistemit, paraqitet si vijon:

Ekuacioni 4-3 Kostot e Balancimit të OST

$$BCOS_t = CSOB_t + BSCC_t + SINC_t$$

$BCOS_t$ Kostot e Balancimit të OST të rigjeneruara nga shfrytëzuesit e sistemit

$CSOB_t$ Kostot Neto të OST të ofertave të pranuar në mekanizmin e balancimit

$BSCC_t$ Kostot Neto të OST të kontratave për disponueshmëri ose të shfrytëzimit të shërbimeve balancuese, duke përjashtuar kostot e përfshira në $CSOB_t$

$SINC_t$ Rregullimi stimulues i OST, kalkuluar si më poshtë

Ekuacioni 4-4 MSST

$$SINC_t = BASF_t * (TABC_{t-1} - CSOB_{t-1} - BSCC_{t-1}) * (1 + INTR_t)$$

Nëse

If $SINC_t < 0$, $SINC_t = \max \text{ë}SINC_b, BLLM_{t-1}\zeta$

If $SINC_t > 0$, $SINC_t = \min \text{ë}SINC_b, BULM_{t-1}\zeta$

$BASF_t$ Faktori ndarës I shpenzimeve të Balancimit (%) (e përcaktuar nga ZRRE)

$TABC_{t-1}$ Objektivi për $BCOS_{t-1}$, duke përjashtuar $SINC_{t-1}$ (e përcaktuar nga ZRRE)

$BLLM_{t-1}$ Kufiri i ultë në pagesat stimuluuese të shpenzimeve të balancimit për OST (e përcaktuar nga ZRRE)

$BULM_{t-1}$ Kufiri i lartë në pagesat stimuluuese të shpenzimeve të balancimit për OST (e përcaktuar nga ZRRE)

Gjatë periudhave fillestare të tregut të ri, mundësia e OST-së për të kontrolluar pagesat e balancimit, do të jetë tepër e kufizuar. Vetëm një numër i vogël i gjeneratorëve do të paraqesin ofertat për shtim apo ulje të prodhimit dhe çmimet e këtyre ofertave do të rregullohen nga rregullat e tregut. për këtë arsye, ekspozimi i OST-së ndaj ndryshimeve në të ardhurat e lejuara sipas MSST-së, do të mbetet i vogël dhe në periudhën fillestare mund të jetë zero. Kjo gjithashtu do të lejojë një periudhë të operimit “në hije” në të cilën ZRRE-ja dhe OST-ja do të mund të hetojnë saktësinë e parashikimeve të OST-së kundrejt kostove ekzistuese.

Për tregun kalimtar, MSST-ja dhe përbërësit e vet do të vendosen në zero.

4.12 Kontrolli i Çmimit

4.11.1 Shndërrimi i kostove të lejuara në të ardhura të lejuara

Gjatë periudhës së kontrollit të çmimit, vlera aktuale (VA) e të ardhurave të lejuara të OST-së duhet të barazohet me kostot e lejuara të përcaktuara, siç përshkruhet më poshtë. Sidoqoftë, nuk kërkohet që të ardhurat e lejuara dhe kostot e lejuara të jenë të barabarta gjatë çdo viti. Në fakt, kjo mund të paraqesë paqëndrueshmëri substanciale të tarifave, gjë që nuk është as në interes të konsumatorëve e as të OST-së.

Në Figurën 5 më poshtë, është ilustruar qasja e përgjithshme për përcaktimin VA-së të kostove të lejuara dhe të VP-ve përkatëse të të ardhurave në kuadër të kontrollit të çmimit. Ky është një shembull i mesatares së të ardhurave “tavan” – shfrytëzimi i të cilave nuk nënkupton që ZRRE-ja do të aplikojë kontroll çmimi të kësaj forme. Sidoqoftë, qasja e përgjithshme vlen për të gjitha format e kontrollit të çmimit.

Fig. 5 Përcaktimi i të hyrave të lejuara (“tavan” i të hyrave mesatare)

Të gjithë numrat janë vetëm ilustrim

Assumptions		WACC	10.0%			
		Asset life	25 years			
Year		0	1	2	3	Total
Discount factor		1.000	0.909	0.826	0.751	
Regulatory Asset Base (RAB)						
Opening RAB	€m		0.00	8.00	17.68	
Capital expenditure	€m		8.00	10.00	6.00	
Depreciation	€m		0.00	-0.32	-0.71	
Closing RAB	€m	0.00	8.00	17.68	22.97	
Average RAB for year	€m		4.00	12.84	20.33	
Allowed return (WACC * average RAB)	€m		0.40	1.28	2.03	
Allowed Costs						
Operating costs	€m		1.30	1.29	1.27	
Depreciation	€m		0.00	0.32	0.71	
Allowed return	€m		0.40	1.28	2.03	
Debt service (pre-2005 assets)	€m		0.00	0.00	0.00	
Infrastructure renewals (pre-2005 assets)	€m		4.00	4.00	4.00	
Total allowed costs	€m		5.70	2.89	4.01	
PV allowed costs	€m		5.18	2.39	3.02	10.59
less Excluded Revenues						
Congestion management revenue			(Not included in price control calculation - incorporated through adjustment factor in price control formula)			
Allowed Revenues						
Average revenue	€/kWh	0.125	0.112	0.101	0.091	
		P_0	$P_1 = P_0 * (1 + P_0 \text{ Adj}) * (1 - X)$	$P_2 = P_1 * (1 - X)$	$P_3 = P_2 * (1 - X)$	
Volumes transmitted	GWh		4,000	4,200	4,410	
Total allowed revenues	€m		4.49	4.24	4.00	
PV allowed revenues	€m		4.08	3.50	3.00	10.59
Price Control Parameters						
	P_0 adjustment	0.0%				
	X-factor	10.2%				

1. Select P_0 adjustment

2. Set X, such total PV allowed revenues is equal to total PV allowed costs

Përlllogaritja është ndërmarrë në kushte të vërteta, duke shfrytëzuar normën zbritëse të barabartë me MPKK-në e OST-së.

Gjatë shpërndarjes së të ardhurave të lejuara, ZRRE-së do t’i kërkohet që të zgjedhë një rregullim fillestar të çmimit të ardhurave të rregulluara P_0 dhe rregullimin e vërtetë vjetor, faktorin-X, të mjaftueshëm për barazimin e të ardhurave të lejuara me shpenzimet e lejuara përgjatë periudhës së kontrollit të çmimit. Kjo kërkon balancim midis:

- Rregullimit të madh fillestar P_0 , i cili çon drejt një X-faktori të vogël. Në ekstrem, rregullimi P_0 shfrytëzohet për të korigjuar të gjitha dallimet çmimit/të ardhurave aktuale dhe nivelit efikas të përcaktuar nga ZRRE-ja. Në këtë rast, X-faktori prezanton ndryshimin e vërtetë vjetor të pritur në shpenzimet e kompanisë, e cila është duke operuar në nivel efikas të shpenzimeve.
- Rregullimit të ulët P_0 , i cili çon drejt X-faktorit të madh. Në ekstrem, asnjë rregullim P_0 nuk aplikohet në rregullimin e niveleve efikase të shpenzimeve që kryhet përmes X-faktorit.

Qasja e parë nuk kërkon që konsumatorët të paguajnë për ndonjë jo efikasitet ekzistues. Sidoqoftë, supozohet se OST-ja mund t'i përmirësojë menjëherë shpenzimet e vetanake, deri në një nivel efikas, diçka që mund edhe të mos realizohet. Në veçanti, kur në përmirësimin e shpenzimeve ekzistuese në nivel efikas paraqiten ndikime të rëndësishme sociale, mund të jetë më e përshtatshme që këto të fundit të lejohen. ZRRE-ja beson që ky rast i cili do të gjejë zbatim në Kosovë, dhe kështu për kontrollin fillestar të çmimit, do të favorizojë qasjen sipas ë cilës P_0 ka pak ose aspak rregullim dhe X-faktori është më i madh.

Gjatë vitit të parë të kontrollimit të çmimit, ZRRE-ja do të caktojë një vlerë fillestare për të ardhurat vjetore të lejuara, pa përcaktuar një rregullim P_0 , pasi ndryshimi në qasjen rregullatore prej viteve paraardhëse do të thotë se kjo është thellësisht e pakuptimtë. Rregullimi P_0 do të aplikohet në fillim të çdo periudhe pasuese të kontrollit të ri të çmimit.

4.11.2 Kohëzgjatja e kontrollit të çmimit

Sipas një kontrolli të çmimit bazuar në simulim (nxitje), ekuilibri duhet të jetë i mbyllur në mes periudhës më të gjatë të kontrollit të çmimit, e cila simulon në masë të madhe kompanitë që të zvogëlojnë kostot e tyre (meqë mbajnë fitimin për më gjatë), dhe periudhës më të shkurtër, e cila redukton rrezikun që kostot aktuale dhe të ardhurat vjetore të lejuara të devijojnë në shuma të tepruara.

Kur ka paqartësi të theksuara lidhur me ekzistimin e të dhënave ose me parashikimet e ardhshme, te dyja të aplikuar në Kosovë, atëherë theksi më i madh duhet të vihet mbi menaxhimin e këtyre rreziqeve duke shkurtuar periudhat e kontrollit të çmimit. Duke ditur këtë, ZRRE-ja propozon që kontrolli fillestar i çmimit për OST-në të zgjasë tre vjet. Kontrollat vijuese të çmimit mund të zgjasin në periudha më të gjata. Masat mbrojtëse shtesë kundër rreziqeve të paqartësive aktuale në Kosovë, merren nëpërmjet shfrytëzimit të ri-hapësve, siç është përshkruar më poshtë.

4.11.3 Formula e kontrollit të çmimit

Në zhvillimin e formulës së kontrollit të çmimi që do të drejtojë përlllogaritjen e të ardhurave të lejuara të OST-së përgjatë periudhës së kontrollit të çmimit, ZRRE-ja duhet të përcaktojë:

- Cilët do të jenë nxitësit kryesorë të ndryshimeve në kostot e OST-së gjatë periudhës së kontrollit të çmimit që janë jashtë kontrollit të menaxhimit të OST-së?
- Si mund të përfaqësohen këto në formulën e kontrollit të çmimit?

ZRRE-ja mendon se, në afat të shkurtër, kostot e OST-së nuk kanë të bëjnë aspak me numrin e konsumatorëve të shërbyer, sasinë e energjisë së transportuar ose fuqinë maksimale të takuar. Këto, dhe në veçanti ajo e fundit, do të ndikojnë në kërkesat për investime. Sidoqoftë, këto

kërkesa tashmë janë lejuar nëpërmjet aprovimit të ZRRE-së dhe futjes së programeve investuese në kostot dhe e lejuara që do të rigjenerohen përgjatë kontrollit të çmimeve dhe nëpërmjet shfrytëzimit të qasjes “së thellë (deep)”, e cila siguron se shfrytëzuesit e rinj kompensojnë OST-në për kostot që i shkaktojnë në sistem.

Për këtë arsye, ZRRE-ja propozon që kontrolli i çmimit të marrë formën e të ardhurave-“tavan”, ku vlera maksimale e të ardhurave të lejuara që do të rigjenerohet në secilin vit të periudhës së kontrollit të çmimit është fikse, pavarësisht nga vëllimet e transmetuar. Do të përdoret faktori korigjues për rregullimin e dallimit në mes të të ardhurave aktuale të fituara, dhe nivelit të lejuar në vitin paraardhës, si rezultat i dallimit në mes të vëllimeve të parashikuar gjatë kohës kur janë aprovuar tarifat për vitin e ardhshëm, në përputhje me të ardhurat e lejuara sipas kontrollit të çmimit, dhe vëllimeve realë.

Kjo zgjidhje i rrit rreziqet te konsumatorët në atë që parashikimi jo i saktë i vëllimeve shpie në çmime më të larta, pasi vëllimet realë janë më të vegjël se sa ata të shfrytëzuar për përllogaritjen e të ardhurave të lejuara, ndërkohë që të ardhurat reale të lejuara mbesin të njëjta. Sidoqoftë, ZRRE-ja mendon se këto rreziqe janë të arsyeshme dhe një pjesë e vogël e kostove të transmissionit në faturën e konsumatorit përfundimtar, nënkupton se ndikimi i këtij rreziku te këta të fundit, është shumë i vogël.

Teorikisht, ZRRE-ja do të dëshironte që të mund të shfrytëzojë një indeks të kostove që reflekton saktësisht përbërjet dhe ndryshimet në çmimin e të hyrave të shfrytëzuara nga OST-ja. Sidoqoftë, nuk disponohet më asnjë indeks i besueshëm ose indeks individual prej të cilit do të mund të përbëhej një indeks i kostove. Në rrethanat aktuale në Kosovë, i vetmi indeks i ndryshimit të çmimit i bazuar ndërkombëtarisht është Indeksi i Çmimit të Konsumit (CPI) i zhvilluar nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK). Sidoqoftë, kjo nuk ka gjasa të jetë një pasqyrim i mirë i ndryshimeve në kostot e OST-së (dhe të licencuarve të tjerë). Përbërja e IÇK-së dominohet nga artikujt ushqimorë, ndërsa kostot e të licencuarve do të jenë më shumë të lidhur me ndryshimet në kostot e mallrave dhe shërbimeve të importuar. Për këtë arsye, ZRRE-ja propozon të përdoret një IÇP e harmonizuar për Bashkimin evropian në tërësi (duke mbuluar të gjithë shtetet anëtarë) si një indeks i përshtatshëm i kostos ky është një indeks i gjerë dhe pasqyron faktin se shumë kosto të të licencuarve do të nxiten prej kostove në mbarë BE-n dhe jo nga kosto kosovare.

Meqë shpenzimet janë emëruar në Euro dhe ZRRE-ja supozon se financimi gjithashtu vjen nga burimet Euro-të emëruara, nuk ka nevojë që në përllogaritjen e indeksit të kostove të merret parasysh norma e rrezikut të këmbimit.

Më poshtë është dhënë formula për përllogaritjen e të ardhurave të lejuara të realizuara nga OST-ja përgjatë periudhës së kontrollit të çmimeve.

Ekucionioni 4-5 Të ardhurat e lejuara të OST

$$TREV_t = TMAR_{t-1} * (1 + CPI_t - X) + TRAK_t - CONG_t - ITCM_t + TLOS_t + BCOS_t$$

TREV_t Të ardhurat e lejuara të OST nga pagesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit (SHTS)

$TMAR_t$	Maksimumi i të ardhurave të lejuara të OST, para rregullimit për sigurimin e infrastrukturës së transmisionit dhe shërbimeve të operimit të sistemit. Përjashton të ardhurat vjetore të lejuara për sigurimin e shërbimeve të operatorit të tregut.
CPI_t	Indeksi i çmimit të Konsumit të harmonizuar për Bashkimin Evropian. Rritja e publikuar e përqindjes vjetore në vit t-l do të përdoret për të përcaktuar vlerën që do aplikohet në vitin t.
X	Faktori-X, që prezanton ndryshim real vjetor në të ardhurat e lejuara (I përcaktuar nga ZRRE-ja me vlera të ndryshme për secilën kompani)
$TRAK_t$	Faktori Korrigjues për dallimet në të ardhurat e lejuara të OST në vitin vijues që rezultojnë nga dallimet në mes të sasisë së parashikuar dhe reale të transmetuar, të përlogaritura si në Ekuacionin e mëposhtëm 4-6
$CONG_t$	Të ardhurat net të liruara nga fondi i menaxhimit të mbingarkesës. (shiko Seksionin 4.10)
$ITCM_t$	Të ardhurat net ITC (shiko Seksionin 4.1 Error! Reference source not found.), të përlogaritura si në Ekuacionin e mëposhtëm 2-7
$TLOS_t$	Shuma e lejuar e shpenzimeve (shiko Seksionin 4.8 dhe Ekuacioni 4-1)
AS_t	për fazat e tregut kalimtar, barazohet me koston e parashikuar të blerjes së shërbimeve ndihmëse në vit t, plus kostot reale minus ato të parashikuara të blerjes së shërbimeve ndihmëse në vit t-l
$BCOS_t$	Shuma e lejuare e shpenzimeve balancuese (shiko Seksionin 4.10 dhe Ekuacioni 4-3)

Për $t=2007$, ZRRE-ja do të përcaktojë një vlerë për $TMAR_{2007}$ për të zëvendësuar $TMAR_{t-1} * (1 + CPI_t - X)$ në formulën e mësipërme.

Ekuacioni 4-6 Faktori Korrigjues i OST

	$TRAK_t = \{TREV_{t-1} - \bar{e}(TREV_{t-1} / FORT_{t-1}) * TRAN_{t-1}\} * (1 + INTR_t)$
$FORT_t$	Sasitë e parashikuar që dalin nga sistemi i transmisionit për qëllime të rregullimit, të shfrytëzuar për qëllime të kalkulimit të $TREV_t$ në periudhën-l
$TRAN_t$	Sasitë reale që dalin nga sistemi i transmisionit për qëllime të rregullimit, i përcaktuar duke përcjellë përmbushjen e periudhës t

Ekuacioni 4-7 Të Ardhurat e Lejuara ITC

	$ITCM_t = ITCA_{t-1} * (1 + INTR_t)$
$ITCA_t$	Të ardhurat neto reale ITC, të fituara në vitin paraprak.

4.11.4 Ri-hapësit


ZRRE-ja pranon se, pavarësisht prej përpjekjeve të mëdha të saj dhe atyre të OST-së, ende mbetet rreziku i lartë që OST-ja do të realizojë profit jashtëzakonisht të lartë apo të ulët nën cilindo kontroll të çmimit, duke pasur parasysh nivelin e pasaktësisë mbi kosto aktuale dhe të ardhshme në Kosovë. Për periudhën fillestare të kontrollit të çmimit ZRRE propozon që së paku të aplikojë ri-hapësit.

Ri-hapësit marrin formën e provizionit që, nëse një normë reale e kthimit e përfituar nga OST-ja (e përlogaritur në përputhje me kërkesat raportuese rregullatorit të specifikuar nga ZRRE-ja) ndryshon nga MPKK i vlerësuar jashtë shiritit të specifikuar, atëherë ZRRE-ja do të ndërmarrë një rishikim të përkohshëm të kontrollit të çmimit. Ky rishikim i përkohshëm nuk do të përmbajë rishikimin e plotë të shpenzimeve të lejuara të OST-së. Në vend të kësaj, ajo do të përmbajë një rivlerësim të ndryshimeve të parashikuara, kundrejt atyre reale në kostot e të hyrave dhe të

dalave, dhe një rregullim të kontrollit të çmimit në atë mënyrë që, duke shfrytëzuar rezultatet dhe parashikimet e azhuruara të këtyre parashikimeve, OST-ja do të kthehet në atë pozitë ku fitimi i lejuar, do të mund të përputhet me shiritin e specifikuar për kohëzgjatjen e mbetur të kontrollit të çmimit. Për mbajtjen e simulimeve në OST për menaxhimin e kostove të tij, nuk do të kthehet në rendimentin e pranuar të MPKK-së ë vlerësuar. Në vend të kësaj, rregullimet do ta kthejnë atë në nivel të përafërt me atë më të ultë apo më të lartë të kufirit të shiritit, në mënyrë tipike përbrenda pikës së përqindjes.

Ky proces është ilustruar në Figurën 6, më poshtë.

Figura 6 Ri-hapësit e ilustruar



4.13 Të ardhurat dhe kostot e OT

Figura më sipër përjashton kostot direkte të OT-së (stafin, zyrat, harduerin dhe softuerin e nevojshëm). Këto duhet të identifikohen ndaras dhe të aprovohen nga ZRRE-ja si dhe të rigjenerohen nga një komponent i veçantë për pagesat e SHST-së.

Për shkak të paqartësive që rrethojnë këto shpenzime gjatë prezantimit të tregut të ri të energjisë elektrike me shumicë, mundësinë e kufizuar të menaxhimit për kontrollimin e tyre, përveç nëpërmjet proceseve përkatëse të prokurimit (që do të rishikohen veçmas nga ZRRE-ja) dhe pjesës shumë të vogël që ato prezantojnë nga shpenzimet totale, ZRRE-ja pret që të rishikojë dhe aprovonjë shpenzimet vjetore të OT-së në bazë të shpenzimeve të shërbimeve.

5 Pagesat për kyçjen dhe për Shfrytëzim të Sistemit të Transmetimit (SHTS)

5.1 Fushëveprimi i metodologjisë

Do të jetë përgjegjësi e OST-së që t'ia parashtrijë ZRRE-së aplikimet për tarifa ZRRE-ja duke vendosur tarifën e propozuar për pagesën e qasjes dhe shfrytëzimit të sistemit të . Të ardhurat e mbuluara nga këto pagesa duhet të jenë brenda maksimal të përcaktuara nga ZRRE-ja, duke përcjellë qasjen e përshkruar në seksionin 4. Struktura e këtyre pagesave do të përcaktohet nga ndërmarrja, por duhet të përshtatet me parimet e përgjithshme të përcaktuara nga ZRRE-ja dhe të përshkruara në këtë seksion. Këto parime lidhen me:

- Kufirin në mes të aseteve të financuara nga pagesat për (lidhje) në rrjet dhe ato të financuara nga pagesat e SHST-së
- Bazat e pagesës për SHST dhe në veçanti, me shkallën e krahasimit të pagesave nisur nga lokacioni geografik, niveli i tensionit, kërkesa, rrjedhat e energjisë, dhe faktorë të tjerë.
- Rënie e pagesave të SHSTS-së ose cilët shfrytëzues paguajnë cilat pagesa.

Qasjet e detajuara të proceseve dhe përlllogaritjeve për përcaktimin e pagesave individuale, në përputhshmëri me parimet e paraqitura në këtë metodologji, dhe për rishikimin e këtyre nga ZRRE-ja, duhet të kundërshtojnë një raport të raporteve të publikuara nga OST-ja.

5.2 Parimet e përgjithshme

ZRRE-ja përpiket të sigurojë se pagesat e SHTS-së dhe pagesat e qasjes në transmision, janë ekonomikisht efikase - me fjalë të tjera, përpiket të sigurojë që ato do t'iu dërgojnë sinjalet përkatëse shfrytëzuesve të sistemit për sa i përket kostove imponohen nga zgjedhja e lokacionit dhe modeli i shfrytëzimit të sistemit të në tërësi. Pa këto sinjale, shfrytëzuesit e rinj dhe ekzistues nuk kanë simulim për minimizimin e këtyre kostove, dhe si rezultat kostot totale për të gjithë shfrytëzuesit do të rriten.

Në të njëjtën kohë, SHST-ja dhe pagesat e qasjes duhet të jenë të thjeshta, në mënyrë që të ndihmojnë shfrytëzuesit për t'i kuptuar dhe verifikuar, po ashtu duhet të jenë aq të qëndrueshme, sa që t'i lejojnë shfrytëzuesit të parashikojnë pagesat e së ardhmes dhe të marrin vendime të përshtatshme investuese dhe të zbatueshme kundrejt njehsimit aktual dhe detyrimeve të tjera.

5.2.1 Pagesat për kyçje (lidhje)

Duke pasur parasysh dimensionet e vogla të sistemit kosovar dhe ndikimin e madh që kanë kyçjet (lidhjet) individuale në sistemin e , si dhe nevojën e këtij sistemi për investim në përforcimin e rrjetit të tensionit të lartë, ZRRE-ja pretendon që OST-ja do të adoptojë pagesën e “thellë (deep)”. Në këtë mënyrë shfrytëzuesit e rinj të lidhur në sistemin e paguajnë kostot e kyçjes direkte prej lokacionit të tyre në sistemin ekzistues dhe kostot e ndonjë investimi për përforcimin e rrjetit të , në mënyrë që të akomodojnë ngarkesat dhe rrjedhjet shitesë apo të ndryshuara që ata krijojnë.

Pagesa e lidhjes së “thellë (deep)” është më komplekse për t’u aplikuar se sa pagesa e lidhjes së “cekët (shallow)”, në të cilën paguhet vetëm shpenzimi i drejtpërdrejtë i lidhjes. Për më tepër, sistemet komplekse të ndërlidhura, vështirësitë në identifikimin e ndikimit të një lidhjeje të re në ngarkesat dhe rrjedhat e sistemit si dhe kërkesat e investimit, janë më shumë sfiduese. Në të njëjtën kohë, madhësia e një kyçjeje të re lidhur me kërkesat totale, është relativisht e vogël prandaj ndikimet e ndonjë kyçjeje individuale, mund të jenë më të kufizuara. Asnjë prej këtyre kushteve nuk plotësohet në Kosovë, prandaj ZRRE-ja se lidhja e thellë është më e zbatueshme dhe më e përshtatshme.

5.2.2 Pagesat e SHST-së

Me pagesën e lidhjes së thellë, pagesat e SHST-së do të rigjenerojnë kostot e rrjetit të aseteve ekzistuese dhe aseteve të reja që nuk kërkohen për shërbimin e shfrytëzuesve individualë. Këto kosto nuk iu atribuohen shfrytëzuesve individual meqë kostot “e mbetura” nuk duhet të ndikojnë në vendimet për lidhjet në rrjet në të ardhmen. Sidoqoftë, ato vazhdojnë të jenë pjesërisht të përcaktuara nga kërkesat e shfrytëzuesve të rrjetit – nëse një shfrytëzues ekzistues rrit kërkesat e veta duke qëndruar përbrenda kapacitetit të tij të lidhjes, ose e ndërron fuqinë nga orët jashtë pikut dhe në orët e pikut, atëherë kjo do të ndikojë në nevojën për investime në një rrjet të zakonshëm. Prandaj ZRRE-ja propozon aplikimin e pagesave SHST që të rigjenerojë këto kosto të bazuara në kontributin e shfrytëzuesve të rrjetit, në orët e pikut.

ZRRE-ja synon që pagesat e SHST-së për rigjenerimin e kostove të aseteve të zakonshme të rrjetit, duhet të aplikohen ndarazi për shfrytëzuesit që ngarkojnë rrjetin:

- Çështja kryesore në përcaktimin e kostove të rrjetit, është vendosja në lokacionin e shfrytëzuesve. Meqë kostot e zgjedhjes se lokacionit tashmë janë të sinjalizuara nga shfrytëzimi i pagesave të lidhjes, nuk ka nevojë që pagesat SHST të aplikohen për këtë qëllim. Pasi të jetë marrë vendimi për vendndodhje, nuk është e mundur që kjo të kundërshtohet, që do të thotë se shfrytëzimi i pagesave të SHST-së për sinjalizimin e këtyre kostove ndaj shfrytëzuesve të kyçur, nuk do të ngrrejë efikasitetin ekonomik, përveç nëse ndikon në modelet e sistemit, duke inkurajuar shfrytëzimin e reduktuar në orët e pikut në sistem.
- Nëse prej prodhuesve kërkohet që të bëhen pagesat SHST, këto duhet të jenë më të bazuara në kapacitetin lidhës me të drejta të qasjes, sesa në prodhimin e vërtetë, për t’iu shmangur simulimit të gabuar, për reduktimin e prodhimit në periudhën e orëve të pikut. Sidoqoftë, kjo do të thotë se prodhuesit nuk do të jenë në gjendje të reduktojnë pagesat SHST duke ndërruar modelet e sistemit të shfrytëzimit, pasi të jenë lidhur, prandaj nuk ka përfitime efikase nga ky burim. Kjo nuk aplikohet tek ngarkesat, të cilat duhet të paguhen në baza të kontributit të orëve të pikut në sistem.
- Prodhuesit do t’i përçojnë pagesat SHST tek furnizuesit dhe së fundi tek konsumatorët. Kërkesa ndaj prodhuesve për të bërë pagesat SHST, nuk do të thotë se bien pagesat e konsumatorëve.
- Rregullorja e BE-se kërkon që pjesa e pagesave SHST e paguar nga gjeneratorët të jetë 50 % ose më pak, me limit jo më të ulët.

Pagesat e SHST-së do të mbulojnë gjithashtu kostot e OST-së në balancimin dhe operimin e sistemit dhe të OT-së. Këto kosto duhet të mbulojnë si elemente të ndara dhe identifikuese të pagesave, duke lejuar që ato të shpërndahen në mënyra të ndryshme në mes të shfrytëzuesve,

varësisht nga rasti dhe duke iu mundësuar shfrytëzuesve monitorimin e nivelit të këtyre pagesave.

Pagesat e SHST-së duhet të jenë gjeografikisht unike. Dallimet në çmim që imponohen nga shfrytëzuesit e kyçur në lokacione të ndryshme, janë të mbajtura nga shfrytëzimi i pagesave të lidhjes së thellë. Aty ku ekziston kongjestioni në sistemin e transmisionit, do të jetë përgjegjësia e SHST-së që të menaxhojë këtë me koston më të ulët përmes tregtimit të energjisë, duke shfrytëzuar mekanizmin e balancimit.

5.3. Pagesat për Kyçje (lidhje)

5.3.1 Baza e pagesave

Kostot e lidhura me lidhjen e shfrytëzuesit të ri në sistem, përfshijnë kostot e investimeve të nevojshme si dhe një leje kapitali për kostot e mirëmbajtjes gjatë jetës së aseteve. Asetet e duhura janë përcaktuar:

- Për shfrytëzuesin e ri, këto asete që do të ndërtohen, të cilat do të mundësojnë lidhjen e konsumatorit në pikën lidhëse në rrjet dhe ato asete të rrjeteve, që do të ndërtohen në anën e pikës lidhëse ku asetet janë të ndara në mes të shfrytëzuesve të rrjetit për ofrimin e shërbimit ndaj konsumatorëve të rinj pa e reduktuar ose limituar shërbimin e ofruar të shfrytëzuesve ekzistues.
- Për shfrytëzuesit ekzistues, këto asete shtesë që kërkohet të përballojnë ngritjen apo ndryshimin e kapacitetit dhe/ose shfrytëzimin e lidhjes në rrjet në të dy anët e pikës lidhëse.

Pika lidhëse është pika në rrjetin e transmisionit ku shfrytëzimi i aseteve ndryshon nga të qenët i dedikuar ndaj një apo më shumë shfrytëzuesve, ku këta ndajnë kostot e aseteve të kyçjes që zakonisht ndahen midis konsumatorëve.

Vlerësimi i ndikimeve të lidhjeve të reja dhe kostot e shoqëruara do të bazohen në studimet e sistemit dhe kostot standarde të investimeve. Studimet reale mund të bëhen nga OST-ja ose nga konsulentët e punësuar apo nga aplikuesit por duhet të jenë të aprovuara nga OST-ja. Kostot e arsyeshme të lidhura me studimet e ndërmarra nga OST-ja mund të mbulohen nga aplikuesi. Kostot standarde të investimet e shfrytëzuara do të përcaktohen nga OST-ja, bazuar në kostot e njërive historike dhe të parashikuara të investimeve në asete të ngjashme. Aty ku aplikohet, konsulentët e punësuar nga aplikuesi, mund të propozojnë kosto të njërive të investimit për shfrytëzim në përcaktimin e pagesave të lidhjes në rrjet, në këto kosto të rishikuara nga OST-ja.

Në përcaktimin e kostove të lidhjes në rrjet, nga OST-ja kërkohet të sigurojë që asetet e përzgjedhura kanë dimensionin optimal ekonomik që kërkohet, duke pasur parasysh kapacitetin lidhës të shfrytëzuesit, ngarkesat e tjera dhe pritjet në rritjen e ngarkesave të tjera.

5.3.2 Mbulimi i pagesave

Pagesat (lidhëse) do të bëhen në bazë unike dhe duhet të bëhet paradhënia para fillimit të punës. Edhe pse ZRRE-ja pranon se kjo imponon një kosto të rëndësishme paraprake për shfrytëzuesit e

rinj, statusi financiar i mundshëm i OST-së është i atillë që nuk mund të pritët që të bëhet huadhënës i shfrytëzuesve të rinj - që është ajo që përfaqëson kriteri për lejimin e pagesave të taksave të kyçje gjatë kohës.

OST-ja nuk do të përfitojë kthimin në asete të financuara nga pagesat, meqenëse pagesat paraprake shmangin nevojën për financimin e këtyre investimeve nga burimet e veta.

Nëse shfrytëzuesi i dytë më pas në lokacionin e njëjtë sikurse shfrytëzuesi ekzistues i cili ka paguar lidhjen e përcaktuar si më lartë, atëherë prej tyre kërkohet që të zbresin një pjesë të pagesës së lidhjes së shfrytëzuesit ekzistues. Zbritja duhet të jetë proporcionale ndaj ndarjes së aseteve origjinale të lidhjes në funksion nga shfrytëzuesi i ri. Një limit i përshtatshëm duhet të aplikohet në kohëra kur aplikohet ky kusht. ZRRE-ja se nga shfrytëzuesit e dytë të lidhur brenda [7] shtatë vjetësh, pritët të paguajnë një kthim parash ndaj shfrytëzuesit fillestar.

ZRRE-ja si të përshtatshëm lejimin e OST-së për të negociuar zbritjet në pagesat e lidhjes, ku se nëse bëhet kështu, reflekton të mira⁶ të tjera, që pritët të rezultojnë nga e shfrytëzuesve të rinj. Në mënyrë që të rritët transparenca, do të botohen kushtet e çfarëdo zbritjeje dhe justifikimi, dhe do të jenë subjekt i rishikimit dhe aprovimit nga ZRRE-ja.

Shfrytëzuesit ekzistues do të lirohen nga pagesa lidhëse, përveç nëse e rrisin kapacitetin e lidhjes ekzistuese ose edhe ta modifikojnë atë; në këtë rast, ata do të paguajnë kostot shoqëruese. ZRRE se tendenca për të përcaktuar një pagesë të përshtatshme të lidhjes për këta shfrytëzues, do të jetë komplekse dhe jashtëzakonisht subjektive- duke cenuar parimet se pagesat duhet të jenë të thjeshta dhe të zbatueshme për t'u vënë në përdorim. Nuk do të ketë përfitime nga kompensimi i efikasitetit ekonomik të ngritur, meqë këta shfrytëzues tashmë kanë vendosur lidhjen me lokacionin dhe kostot e shoqëruara tashmë janë bërë.

Nëse asetet e përgjithshme të rrjetit fillimisht të financuara nga pagesat kyçëse zëvendësohen në fund të jetës së tyre, kostot e investimit shoqërues do të përfshihen në BAR e OST dhe një pagesë e rendimentit të lejuar dhe zhvlerësimit e përlllogaritur sikurse për raste të përgjithshme. Deri në kohën e zhvendosjes, këto asete konsiderohen të jenë pjesë e rrjetit të përgjithshëm dhe kostot e tyre nuk mund të jenë të shpërndara në mes të shfrytëzuesve. Deri tani, është marrë vendimi fillestar i shfrytëzuesit për lokacionin dhe nuk është e mundur të ndryshohet. Kostot e aseteve të zhvendosura për lidhjen e shfrytëzuesit në pikën lidhëse me rrjetin e përgjithshëm, do të vazhdojnë të mbahen nga ai shfrytëzues.

5.4 Pagesa e SHST

Pagesat e SHST-së të përcaktuara sipas parimeve të kësaj metodologjie do të rigjenerojnë kostot e:

- Investimit dhe mirëmbajtjes së aseteve të përgjithshme të rrjetit.

⁶ Këto mund të vijnë nga një reduktim i pritët për investime në të ardhmen në sistem, humbje më të ulëta të ose ku asetet lidhëse janë të tej rritura për shkak të "trazimit" individual të investimeve, duke krijuar kapacitet shtesë për kërkesa të rritjes në të ardhmen.

- Kostot direkte të operacioneve të sistemit të OST-së, duke përfshirë zyrat, stafin, harduerin dhe softuerin, dhe sipas modelit të tregut kalimtar, kostoja e blerjes së shërbimeve ndihmëse dhe energjisë për të mbuluar humbjet.
- Kostot direkte të OT-së, përderisa ky funksion ndërmerret nga OST-ja.

Secili nga komponentët e kostove duhet të identifikohet ndaras.

Kostot e shoqëruara me operimin e tregut të shitjes me shumicë të energjisë duke përfshirë mekanizmin e balancimit dhe blerjen e shërbimeve ndihmëse do të rigjenerohen përmes mekanizmave të përshkruar në Rregullat e Tregut.

5.4.1. Asetet e përbashkëta të rrjetit

Pagesat e SHST-së për rigjenerimin e kostove të aseteve të rrjetit të përgjithshëm duhet të aplikohen tek konsumatorët që ngarkojnë rrjetin. Meqë kërkesa për këto asete është e orientuar kryesisht nga fuqia maksimale e rrjetit që duhet të shërbehet, pagesat për konsumatorët që ngarkojnë rrjetin duhet të bazohen në kontributin e tyre në sistem gjatë orëve të pikut. ZRRE-ja propozon që kjo të bëhet duke aplikuar pagesat për mesataren e kërkesës së secilit nga shfrytëzuesit në kohën e 5 (pesë) paraqitjeve të pikut më të lartë në sistem gjatë çdo viti.

ZRRE-ja mendon se mund të jetë e përshtatshme që pagesat e rrjetit të përgjithshëm të SHST-së, të ndryshojnë për sa i përket nivelit të tensionit të kycjes, për të rritur transparencën në pagesat rezultuese.

5.4.2 Kostot e operimit të sistemit

Të gjithë shfrytëzuesit e sistemit përfitojnë nga shërbimet e operatorit të sistemit, prandaj duhet të kontribuojnë në rigjenerimin e atyre dhe duhet t'i ofrohen stimulime për të ndihmuar monitorimin e tyre. Për këtë arsye, ZRRE-ja e mendon si të përshtatshme që të dy prodhuesit dhe konsumatorët që ngarkojnë rrjetin, të bëjnë pagesa për SHST-në për të rigjeneruar kostot direkte të operatorit të sistemit.

Kostot direkte të operatorit të sistemit duhet të rigjenerohen përmes një pagese të thjeshtë unike për energjinë që hyn në apo del nga sistemi dhe t'i atribuohen prodhuesit apo furnizuesit (duke përfshirë humbjet e shpërndara të transmisionit). Ngarkesa sipas kësaj mënyre, do të jetë një pagesë e arsyeshme që reflekton koston dhe është e thjeshtë të aplikohet, pasi shfrytëzuesit e mëdhenj, të cilët ka mundësi që të bëjnë nominime më të mëdha në shërbimet e operatorit të sistemit, do të paguajnë një pjesë më të madhe të shpenzimeve.

5.4.3 Kostot e OT-së

Sikurse me funksionin e operatorit të sistemit të OST-së, të gjithë shfrytëzuesit, qofshin ata gjeneratorë apo ngarkues, do të përfitojnë nga shërbimet e OT-së. Pagesat e SHST-së për rigjenerimin e kostove direkte të OT-së duhet të aplikohen në bazë të njëjtë.

6 Të ardhurat vjetore të OSSH-së

6.1 Fushëveprimi i Metodologjisë

Të ardhurat e lejuara të OSSH-së mbulojnë ato kosto të lidhura me kushtet e tensionit të mesëm dhe të ulët të sistemit të shpërndarjes brenda Kosovës. Këto përfshijnë shpenzimet e:

- Ndërtimit të sistemit të shpërndarjes;
- Mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes dhe
- Operimit të sistemit të shpërndarjes

6.2 Parimet e Përgjithshme

Shpenzimet dhe të ardhurat e lejuara për OSSH-në përlllogariten në mënyrë të ngjashme me ato të OST-së (shiko seksionin 4). Prandaj këto parime dhe pjesa tjetër e këtij seksioni përshkruajnë aspektet e përlllogaritjes që dallojnë nga ato që aplikohen në OST.

Dallimi më i rëndësishëm është ai që ka të bëjë me trajtimin e humbjeve. OSSH-ja do të marrë përgjegjësitë për humbjet teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes.

OSSH-ja kombinon funksionet e OSSH-së përbrenda saj. Në përgjithësi këto funksione barten në mënyrë pasive dhe OSSH-ja nuk pritet të merret me tregti aktive të energjisë. Ajo mund të ndërmarrë aktivitete si kontraktimin me prodhimin e shpërndarë ose ri-hartimin e rrjeteve që të minimizojë humbjet, por stimulimet për këto janë tashmë të ofruara përmes përlllogaritjes së humbjes së lejuar. Për këtë arsye nuk ofrohet ndonjë përlllogaritje e veçantë e kostove të lejuara të funksioneve apo të simulimeve të OSSH-së, për reduktimin e kostove të sistemit të operimit.

OSSH-ja gjithashtu nuk do të marrë të ardhura nga menaxhimi i mbingarkesës ose mekanizmi i ITC-së dhe çështjet lidhur me këto mund të mos përfillen.

6.3 Humbjet

OSSH-ja do të marrë një shumë të lejuar për humbje të arsyeshme komerciale dhe teknike në rrjetin shpërndarës. Këto shuma të lejuara shfrytëzohen nga OSSH-ja për të kompensuar furnizuesit për shpenzimet e humbjeve që nuk janë të caktuara sipas Rregullave të Tregut.

Vlera e shumës së lejuar për humbje teknike apo komerciale, së paku në fillim do të përlllogaritet në mënyrë të njëjtë sikurse humbjet e lejuara të , me fjalë të tjera, çmimi i simuluar i çmimit, për çdo orë, shumëzuar me sasinë e parashikuar të energjisë që hyn në rrjetin e shpërndarjes në atë orë, shumëzuar me nivelin e lejuar të humbjes (%) në atë orë. Në fund të çdo viti do të bëhet ri-konsolidimi në mes të kësaj shume të lejuar dhe shpenzimeve të humbjeve nëse ato përlllogariten duke përdorur çmimet reale të tregut dhe sasinë e energjisë, përderisa vazhdohet të shfrytëzohet niveli i lejuar i humbjes më shumë sesa ai aktual. Diferenca do të aplikohet si një faktor korrigjues në të ardhurat e lejuara të OSSH-së në vitin vijues.

ZRRE-ja pret që të bëhet dallimi në mes të humbjeve teknike dhe komerciale në mënyrën e financimit të këtyre shumave të lejuara. Shuma e lejuar për humbje teknike do të shtohet shpenzimeve të lejuara të mbuluara nga pagesat e SHSSH sikurse shuma e lejuar për humbjet e transmissioinit rigjenerohet nga pagesat e SHST. Sidoqoftë ZRRE pret që shumat e lejuara për humbjet komerciale të financohen nga BKK me të vetmin korigjim për dallimet në mes të vlerës aktuale dhe të parashikuar të kësaj shume të lejuar duke kaluar në pagesat e SHSSH.

Formula për përcaktimin e humbjeve të lejuara, që do të përfshihen në të ardhurat e lejuara të mbuluara nga pagesat e SHSSH, paraqitet si më poshtë:

Ekuacioni 6-1 Shuma e lejuar e humbjeve gjatë shpërndarjes

$$DLOS_t = DALO_t * FDIS_t * FWEP_t + DLAD_t$$

DLOS_t Shuma e lejuar e humbjeve teknike të shpërndarjes e përfshirë në kontrollin e çmimit (€).

DALO_t Niveli I lejuar I humbjeve (%) – mesatarja e Ponderuar gjatë vitit nga energjia e parashikuar që hyn në rrjetin e shpërndarjes për çdo orë.

FDIS_t Energjia e parashikuar që hyn në rrjetin e shpërndarjes (GWh)

DLAD_t Rregullimet për të korigjuar dallimet në mes të shumës së lejuar të humbjes në vitin vijues bazuar në energjinë e parashikuar të shpërndarë dhe çmimet e tregut dhe energjinë reale të shpërndarë, si dhe dallimet në mes të humbjeve të parashikuara dhe humbjeve të realizuara komerciale dhe të transmetimit. E kalkuluar si më poshtë:

Ekuacioni 6-2 Faktori rregullues i humbjeve gjatë shpërndarjes

$$DLAD_t = \{DALO_{t-1} * [ADIS_{t-1} * AWEP_{t-1}] - (DLOS_{t-1} - DLAD_{t-1}) * (1 + INTR_t)\}$$

ADIS_t Energjia reale që hyn në rrjetin e shpërndarjes (GWh)

6.4 Të ardhurat dhe shpenzimet e hequra

Sipas ligjit, OSSH-ja është pronar i njehsorëve të konsumatorëve. Asetet për njehsim si të ndryshme nga shpenzimet e leximit të këtyre njehsorëve do të përfshihen në të ardhurat e mbuluara nga pagesat e SHSSH-së për njehsorët ekzistues (në të njëjtën mënyrë si për asetet e tjera të para 2005). Për njehsorët e rinj, kostot do të rigjenerohen përmes pagesave të lidhjes për konsumatorët e rinj ose nëse njehsori tjetër ndërrohet për shkak të ndërrimit të konsumatorit apo kërkesës së konsumatorit ekzistues, njehsorit ekzistues i ka tejkuluar jetëgjatësia. Kostot e këtyre njehsorëve do të përjashtohen nga përlllogaritja e kostove të lejuara dhe nga përlllogaritja e të ardhurave.

Konsumatorët dhe prodhuesit e vegjël të kyçur në rrjetin e shpërndarjes do të bëjnë pagesën e lidhjes së cekët. Kostot e përforcimit të sistemit nga lidhjet e reja të këtij lloji, do të përfshihen në kostot e lejuara dhe të ardhurat e rigjeneruara nga pagesat e SHSSH-së. Kjo dallon nga qasja e adoptuar në nivelin e transmetimit.

6.5 Kontrolli i çmimit

Kontrolli i çmimit të OSSH-së do të ndjekë të njëjtën qasje me atë të OST-së për sa i përket gjatësisë dhe zgjedhjes së indeksit të shpenzimeve. Megjithatë, ZRRE-ja propozon miratimin e çmimit hibrid dhe kontrollin e të ardhurave tavan, më shumë se sa adoptimin e të ardhurave tavan. Kjo pranon se është e përshtatshme që t'iu lejohet të ardhurave të OSSH-së të rriten ashtu si dhe sasia e energjisë së shpërndarë, pasi konsumatorët e shërbyer rrisin:

- Shfrytëzimin e pagesave të lidhjes së cekët do të thotë se jo të gjitha kostot për kyçjen e konsumatorëve të rinj dhe përmbushjet e kërkesave në rritje, mund të mbulojnë nga OSSH-ja;
- Përfshirja e elementit të çmimit tavan forcon edhe më shumë stimulimin ndaj OSSH-së për reduktimin e humbjeve komerciale-që është njëra ndër fushat më shqetësuese, dhe ku mund të ndërmerren reduktime, madje në shumë raste, pa nevojën e investimeve në shkallë të gjerë që kërkojnë aprovimin nga ZRRE-ja. Me rritjen e vëllimeve të faturuar, do të rriten edhe të ardhurat e OSSH-së.

Numri i konsumatorëve dhe sasi të shpërndara ndikojnë në kostot e OSSH-së. ZRRE-ja pret që të lidhë komponentin e çmimit tavan të kontrollit me vetë sasi të. Kjo bëhet, pasi që numri i konsumatorëve dhe sasi të janë të lidhura e poashtu edhe sepse ofron stimulim të përshtatshëm për reduktimin e humbjeve komerciale (të ardhurat e OSSH-së do të shkojnë duke i rritur të ardhurat e saj, në rast se ngrihet, por numri i konsumatorëve do të bjerë, gjë që mund të jetë rezultat i një fushate që bëhet për reduktimin e humbjeve komerciale).

Ekuacioni 6-3 Të ardhurat e lejuara të OSSH-së

$$DREV_t = DMAR_{t-1} * (1 + CPI_t - X) * [(1 - PCAP) + PCAP * (FVOL_t / AVOL_{t-1})] + (PCAP * DISK_t) + DLOS_t$$

DREV_t Të ardhurat e lejuara të OSSH nga pagesat e SHSHS

DMAR_t Të ardhurat e lejuara maksimale, para rregullimeve

CPI_t Indeksi I çmimit të konsumit për BE-në. Rritja e përqindjes vjetore të publikuar gjatë vitit t-1 do të përdoret për të përcaktuar vlerën që të aplikohet në vitin t

X Faktori-X, duke prezantuar ndryshimin real vjetor në të ardhurat e lejuara (të përcaktuara nga ZRRE me vlera dalluese për secilën ndërmarrje)

PCAP_t çmimi tavan I Ponderuar në kontrollin e çmimit (% , pjesë të kostove që supozohet të jenë të varura në ndryshimet në sasi) (i përcaktuar nga ZRRE)

FVOL_t Energjia e parashikuar për furnizimin e konsumatorëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes

AVOL_t Energjia reale për furnizimin e konsumatorëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes

DISK_t Faktori korigjues për dallimet në të ardhurat e lejuara në vitin vijues që rezultojnë nga dallimet në mes të furnizimit të sasisë reale dhe të parashikuar, e kalkuluar siç shihet në ekuacionin Ekuacioni 6-4, më poshtë

DLOS_t Shuma e lejuar e humbjeve (shiko Seksioni 6.3 dhe Ekuacionin 6-1)

Për t=2007, ZRRE-ja do të përcaktojë një vlerë për DMAR₂₀₀₇ për të zëvendësuar DMAR_{t-1}

Ekuacioni 6-4 Faktori i korigjues i OSSH

$$DISK_t = \{DREV_{t-1} - \dot{e}(DREV_{t-1} / FVOL_{t-1}) * AVOL_{t-1}\} * (1 + INTR_t)$$

6.5.1 Ri - Hapësit

Ri-hapësit do të aplikohen në mënyrë të ngjashme sikurse ato të aplikuar në OST.

7. Pagesat për lidhje të SHSSH

7.1 Fushëveprimi i metodologjisë

Të ardhurat e lejuara të OSSH-së mbulojnë këto shpenzime të lidhura me kushtet e nivelit të ulët dhe të mesëm të sistemit të shpërndarjes brenda Kosovës. Këtu përfshihen kostot e ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të shpërndarjes. Për dallim nga pagesat e OSSH-së, ZRRE-ja nuk e mendon si të domosdoshëm dallimin këtyre kategorive për arsye të përcaktimit të pagesave të SHSSH-së, por vetëm për ato kosto që mbulohen nga pagesat për kyçje, dhe prej atyre shpenzimeve që mbulohen nga pagesat e SHSSH-së. Kjo pasqyron rëndësinë më të vogël të funksionit të operimit të sistemit në shpërndarje, dhe mungesën e ekuivalentit të OT-së.

Sa i përket pagesave të transmetimit, pritet që DSO-ja të publikojë një deklaratë të proceseve dhe qasjet e përlogaritjeve që përdoren për përcaktimin e kyçjeve individuale dhe pagesave të SHSSH-së.

7.2 Parimet e përgjithshme

Sipas përshkrimit të pagesave të SHST-së dhe atyre të kyçje (shiko Seksionin 5), ZRRE-ja favorizon shfrytëzimin e pagesave të kyçjes së thellë në nivelin e shpërndarjes, që reflekton një ngritje të përgjithshme në efikasitetin e këtyre pagesave. Megjithatë, aplikimi i pagesave të lidhjes së thellë nuk është i mundshëm për të gjithë konsumatorët, pavarësisht nga madhësia e tyre. Duke pasur parasysh ndikimin e kufizuar në sistemin ekzistues, përfitimet e konsumatorëve të vegjël me efikasitetin ekonomik janë të papërfillshme dhe të stërngarkuara nga kostot e shoqëruara me ndërmarrjen e studimeve të nevojshme të sistemit dhe analizave për përcaktimin e pagesave të lidhjes së thellë.

Shfrytëzimi i pagesave të lidhjes së cekët, d.m.th roli i pagesave të SHSSH-së në shpërndarjen e sinjaleve të përshtatshme të shpenzimeve, është në rritje. Edhe pse nuk ka tendenca që në këtë fazë të paraqiten pagesat të SHSSH-së që dallojnë për nga vendndodhja gjeografike, pagesat e SHSSH-së duhet të ndryshojnë për nga niveli i tensionit të rrjetit në të cilin është i lidhur konsumatori.

7.3 Pagesat për kyçje

7.3.1 Baza e pagesave

Pagesat e lidhjes së thellë do të aplikohen tek prodhuesit e mëdhenj. ZRRE-ja si të përshtatshëm përcaktimin e këtyre prodhuesve si prodhues që kalojnë kapacitetin 5MW, dhe të cilët janë të detyruar që të pajisen me licencë përkatëse. Rregullimet për përlllogaritjen e pagesave të lidhjes për këta prodhues, do të jenë të njëjta me ato të aplikuara për përlllogaritjen e pagesave të thella të lidhjes për shfrytëzuesit e rrjetit të transmisionit.

Prodhuesit e vegjël dhe konsumatorët që e ngarkojnë rrjetin do të bëjnë pagesën e kyçje së cekët, duke i mbuluar vetëm shpenzimet e asetëve të reja apo asetëve shtesë që lidhin konsumatorin në pikën lidhëse të rrjetit të shpërndarjes.

Për konsumatorët më të vegjël të ndodhur afër rrjetit ekzistues, dhe aty ku ka kërkesë vetëm për investimet e kufizuara, do të aplikohet një orar i punimeve standarde të lidhjes dhe kosto tjera, në mënyrë që të minimizojë kostot e konsumatorëve dhe OSSH-së në aplikimin e lidhjeve të reja dhe të zmadhuara.

Detajet e ofertës standarde, përfshirë shërbimet që do të sigurohen, procesin për përlllogaritjen e tarifave dhe pagesave të këtyre, si dhe variacionet e ofertës standarde për të futur kritere të ndryshme shërbimi, ose në rast se vendndodhja e konsumatorit apo rrethanat nënkuptojnë që oferta standarde nuk mund aplikohet, do të përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji (KPFJE), të cilat janë të përshkruara veçmas nga ZRRE-ja.

7.3.2 Mbulimi i pagesave

Tarifat e kyçjes do të vihen në baza unike dhe duhet të paguhen para fillimit të punës. Për sa i përket tarifave për lidhje në rrjetin e transmetimit, asetet e OSSH-së të financuara nga tarifat për lidhje, do të përjashtohen nga BAR-i i shfrytëzuar për përcaktimin e të ardhurave të lejuara të OSSH-së, dhe OSSH-ja nuk do të lejojë përfitimin e rendimentit (kthimit) në këto aset. Nga shfrytëzuesit sekondarë apo vijues që shfrytëzojnë asetet e lidhjes të paguara nga shfrytëzuesi paraprak, pritet që t'i paguajnë një rabat shfrytëzuesit të parë. Shfrytëzuesit ekzistues do të lirohen nga pagesat për kyçje, përveç nëse ata rrisin apo modifikojnë madhësinë e lidhjes ekzistuese.

OSSH-së do t'i lejohet negociimi i lirimeve në pagesa të lidhjes dhe OSSH-ja do të inkurajohet të bëjë kështu për gjeneratorët më të vegjël të shpërndarë, duke ditur kontributin që këta gjeneratorë mund të japin për të reduktuar shpenzimet e sistemit të shpërndarjes, duke zvogëluar nevojën për investime të reja dhe duke reduktuar humbjet. Baza e përcaktimit të këtyre lirimeve si dhe kufizimet e llojeve të teknologjisë prodhuese që janë të privilegjuara, duhet të përcaktohen në rregullat standarde të publikuara nga OSSH-ja. Këto kërkojnë aprovim nga ZRRE-ja.

7.4 Pagesat e SHSSH-së

Për efikasitet ekonomik kërkohet që pagesat të reflektojnë kostot e imponuara nga vendimi i prodhuesit individual ose konsumatorit të ngarkuar për rritjen e shfrytëzimit të sistemit nga një njësi shtesë-të kostove të tyre marxhinale (kufitare). Nëse aplikohen pagesat e thella të lidhjes si te prodhuesit e mëdhenj, atëherë këto mbahen nëpërmjet përlllogaritjes së kostove të konsumatorëve të rinj të lidhur duke përfshirë edhe investimet në rrjetin e zakonshëm. Për këta shfrytëzues, kostot duhet të sinjalizohen përmes pagesave të SHSSH-së. Pagesat e SHSSH-së duhet të dallojnë për nga niveli i tensionit në të cilin është lidhur shfrytëzuesi, nga ato që janë të lidhur në tension të lartë që nuk paguajnë shpenzime të aseteve të nivelit të ulët të tensionit.

Shuma e përshtatshme e kostove marxhinale për qëllim të përcaktimit të pagesave të SHSSH-së sipas kësaj qasjeje, është një kosto afatgjatë (LRMC) – që është më e qëndrueshme se sa kostoja afatshkurtër (SRMC), dhe e cila, në mungesë të tregjeve në qasjen e rrjetit në nivelin e shpërndarjes, mban më mirë implikimet e investimeve për vendimin e rritjes së shfrytëzimit të rrjetit të shpërndarjes. Më thjeshtë, në përgjithësi është e përshtatshme që të përafrohet LRMC-ja duke përlllogaritur kostot rritëse mesatare afatgjatë të LRAIC duke prezantuar PV-në e investimeve shtesë dhe kostot operuese të lidhura me arritjen e përmbushjes së ngritjes konstante të kërkesës. Kjo mund të përlllogaritet duke përdorur programet e planifikuara të investimeve që të arrijnë rritjen e parashikuar të kërkesës dhe duke vlerësuar kërkesat e rritura të investimeve që rezultojnë nga rritja e kërkesës, duke përdorur një model të plotë apo të stilizuar. Ky i fundit është ekonomikisht më efikas duke por e ka kompleksitetin e shtuar.

Duke shfrytëzuar secilën prej qasjeve, kërkohen një sërë parametrash themelore. ZRRE-ja synon që të aplikohen këto:

- Shtrirje të kohëzgjatjes prej 10 (dhjetë) vjetësh.
- Norma e zbritjes (e shfrytëzuar nga përlllogaritjet e PV-së) e barazuar me MPKK-në e vlerësuar të OSSH-së .
- Rritja e kërkesës (e shfrytëzuar nëse aplikohet modeli i sistemit) e barazuar me përafërsisht 10% të kërkesës së pikut.

Do të jetë e nevojshme që të lidhen të ardhurat rezultuese që mund të rigjenerohen nga aplikimi i pagesave LRAIC, me ato të lejuara në kontrollin e çmimit, që aplikohen në OSSH. Kjo duhet të bëhet duke shtuar ose duke zbritur faktorin e zakonshëm, në mënyrë që pagesa finale të jetë konstante me të ardhurat e lejuara siç shihen në formën e thjeshtësuar më poshtë:

$$\sum_i \sum_t (SHSHS_{i,t} DFAC_t) * FVOL_{i,t} = DREV_t$$

$DLRC_{i,t}$ $LRAIC$ *Pagesa për kategorinë e konsumatorëve i (€/kW)*
 $DFAC_t$ *Faktori i përgjithshëm stimulus i aplikuar për secilën pagesë (€/kW)*

Baza e pagesave të SHSSH-së duhet të jetë kërkesë e shfrytëzuesve individualë në kohën e pikut në sistem. Në shumë raste, rregullimet ekzistuese të njehsorëve nuk do jenë adekuate për matjen e kësaj, dhe duhet të aplikohen supozime të përshtatshme të bazuara në profilet e ngarkuara ose informata të tjera.

OSSH-ja do të inkurajohet t'iu ofrojë prodhuesve më të vegjël të shpërndarë, lirim dhe reduktime në pagesat e SHSSH-së, aty ku këto oferta të zbritjeve në pagesat për lidhje janë të papërshtatshme për të pasqyruar përfitimet e këtyre prodhuesve. Parimet dhe bazat për përcaktimin e këtyre rabateve dhe reduktimeve, duhet të përfshihen në rregullat standarde të publikuara për këtë qëllim nga OSSH-ja.

8 Blerjet prej prodhuesve jo-publikë pa certifikata të origjinës

Në përgjithësi, blerjet prej prodhuesve jo-publikë do të bëhen me çmime të përfshira në MBE-të përkatëse, ku kostot i përçohen tarifave të pakicës.

ZRRE-ja pret që termat e MBE-ve ekzistuese të mbeten të pandryshueshme. Në përgjithësi, ZRRE-ja do të presë se çdo MBE e re ose e ndryshuar që është bërë prej Furnizuesit Publik me prodhuesit jo-publikë, do të jetë i qëndrueshëm me blerjet ekonomike ose me kosto të ulëta. MBE-ja rezulton prej një procesi tenderimi konkurrues, dhe në përgjithësi do të merret në shqyrtim për të plotësuar këtë kriter.

Nëse një MBE nuk rezulton prej një procesi tenderimi, ose niveli i konkurrencës ka qenë i papërshtatshëm, (për shembull, me vetëm një ofertë të marrë), atëherë ZRRE-ja do të vlerësojë natyrën ekonomike të çmimit të ofruar kundrejt krahasimeve. Këto do përfshijnë:

- Kostot historike të blerjeve të tjera të energjisë, përfshirë importet.
- Çmimet e shumicës të marrë prej MSTs.
- Kostot marxhinale afatgjata (LRMC) të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë (ë përfaqëson çmimin e përmbushjes së kërkesës së re).

Nëse ZRRE-ja mendon se kostot e blerjes së energjisë të përfaqësuara nga MBE-ja janë të tepërta, mund t'i kërkojë Furnizuesit Publik të hyjë në një MBE të re, ose, mos të lejojë një pjesë të kostove të blerjes së energjisë sipas MBE-së, për qëllimet e përcaktimit të kostove që do t'i përçohen konsumatorëve jo të privilegjuar.

Blerjet prej prodhuesve jo-publikë me certifikata të origjinës

[Ky seksion është lënë bosh qëllimisht]

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Anëtarët e Bordit:
